

ANALIZË E NEVOJAVE PREJ HARMONIZIMIT TË KODIT PENAL ME KONVENTËN E STAMBOLLIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Autorë:

Dr. Maria Risteska

Mr. Aleksandar Cekov

Shkup, 2019





ANALIZË E NEVOJAVE PREJ HARMONIZIMIT TË KODIT PENAL ME KONVENTËN E STAMBOLLIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Autorë:

Dr. Maria Risteska

Mr. Aleksandar Cekov

Shkup, 2019

IMPRESUM

Për botuesin:

Qendra për Hulumtim dhe Krijim të Politikave dhe Lobi i gruas maqedonase

Autorë:

dr. Marija Risteska dhe mr. Aleksandar Cekov

Dizajni:

Armarium

Kjo analizë është punuar në kuadër të projektit “Përfaqësimi dhe dialogu në nivel të ekspertëve me Qeverinë dhe Parlamentin për ndryshimin e legjislaturës ekzistuese në fushën e dhunës së bazuar dhe diskriminimit”, në zbatim të Lobit të gruas maqedonase në partneritet me Qendrën për hulumtim dhe krijim të politikave, në kuadër të Programit rajonal të Bashkimit Evropian dhe UN Women “Parandalimi i dhunës ndaj grave dhe vajzave: Implamentimi i normave – ndryshimi i qëndrimeve”.

Ky publikim është përpunuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është lëndë e përgjegjësisë së Lobit të Gruas maqedonase dhe Qendrës për hulumtim dhe krijim të politikave dhe nuk i paraqet qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Përmbajtja e këtij publikimi nuk i paraqet qëndrimet e Trupit të KB-së për zhvillimin e barazisë gjinore dhe përforcimin e grave UN Women, Këshillit ekzekutiv të tyre apo vendeve anëtare të Kombeve të Bashkuara. Shënimet në këtë publikim nuk nënkuptojnë opinion për statusin ligjor të ndonjë vendi apo territori, autoriteteve të tyre ose për kufizime kufitare. Teksti nuk është rregulluar sipas standardeve zyrtare të botimit dhe UN Women nuk pranon asnjë përgjegjësi për ndonjë gabim.

PËRMBAJTJA

1	Hyrje.....	7
2	Termat kryesorë të përkufizuar në Konventën e Stambollit dhe legjislaturën e Maqedonisë së Veriut	12
2.1	Drejt politikës së plotë për dhunën kundër grave – perspektiva komparative nga Ballkani Perëndimor	17
2.2	Konstatime për përkufizimin e termave kryesorë të përcaktuara me Konventën e Stambollit.....	19
3	Kodi Penal dhe format e ndryshme të dhunës ndaj grave.....	22
3.1	Dhuna psikike dhe fizike në Konventën e Stambollit (neni 33 dhe neni 35)	23
3.2	Dhuna seksuale dhe përdhunimi (neni 36)	28
3.2.1	Forma të dhunës seksuale në Legjislaturën e Maqedonisë së Veriut.....	29
3.2.2	Analizë e hendekut midis legjislaturës së Maqedonisë së Veriut dhe Konventës së Stambollit	31
3.2.3	Analizë krahasuese lidhur me rregullimin e veprës penale përdhunim në legjislaturat e disa prej vendeve të rajonit.....	35
3.3	Përndjekja (neni 34)	37
3.4	Shqetësimi seksual (neni 40)	39
3.5	Martestat e dhunshme (neni 37).....	42
3.6	Gjymtimi i gjenitaleve femërore (neni 38)	44
3.7	Arsyetimi i papranueshëm i krimeve, duke i përfshirë krimet e kryera në emër të së ashtuquajturit “nder” (neni 42)	46
4	Rrethanat e rënduara dhe vjetërsi	48

5	Masa të përkohshme për mbrojtjen e viktimave nga dhuna e bazuar gjinore dhe dhuna familjare.....	50
	<i>Përfundime</i>	53
6	Rekomandime.....	55
6.1	Instrumenti për ratifikimin e Konventës së Stambollit.....	55
6.2	Përkufizimi i termave kryesorë të Konventës së Stambollit	55
6.3	Kriminalizimi i të gjitha formave të dhunës ndaj grave	56

Hyrje

Republika e Maqedonisë së Veriut e nënshkroi Konventën e Stambollit në vitin 2011, ndërsa ratifikimi pasoi shtatë vjet më vonë. Me këtë vendi demonstroi vullnet politik që të ballafaqohet me dhunën ndaj grave. Megjithatë, që kjo të bëhet realitet, nevojitet harmonizim i legjislaturës vendore me angazhimet e Konventës. Konventa e Stambollit hyri në fuqi më 1 korrik 2018, ndërsa Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në mënyrë plotësuese e miratoi planin veprues kombëtar për zbatimin e Konventës së Stambolli, ku në nivel qendror janë paraparë aktivitete të ndryshimit të legjislaturës me qëllim të praktikimit të standardeve të Konventës në praktikë.

Në këtë kuptim, Qeveria e RMV me miratimin e Planit veprues i përgjigjet kushtit kryesor të Konventës për të zhvilluar politika të përkufizuara qartë dhe të targetuara të cilat ballafaqohen me të gjitha llojet e dhunës të cilat i përfshin Konventa. Megjithatë, raporti i fundit i gjashti me radhë i Komitetit për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave konstaton se legjislatura e Maqedonisë së Veriut nuk i njeh dhe kriminalizon të gjitha format e dhunës së bazuar gjinore ndaj grave dhe vajzave dhe në sferat publike dhe private, duke e përfshirë dhunën fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike. „Legjislatura ekzistuese e cila e rregullon dhunën në familje është neutrale në aspektin gjinor dhe nuk i njeh aspektet specifike të dhunës në familje“¹.

Për shkak të kornizës ligjore jopërkatese, si edhe mosrregullimit të formave të ndryshme të dhunës së bazuar gjinore, mungon sistem gjithëpërfshirës për grumbullimin e të dhënave lidhur me format e ndryshme të dhunës së bazuar gjinore ndaj grave dhe vajzave, duke përfshirë edhe informacione për marrëdhënien e kryerësit apo autorit të aktit me viktimën. Kështu, ekziston sfidë serioze që të ndiqet shtrirja e lartë

.....
¹ Raporti gjashtë periodik i Komitetit për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave, Vërejtje përfundimtare 2018 në dispozicion në internet: https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW/C/MKD/CO/6&Lang=En

e dhunës së bazuar gjinore ndaj grave dhe vajzave në vend. Studimi i fundit i bërë në vitin 2019 nga misioni i OSBE-së në Shkup detekton përhapje të gjerë të dhunës ndaj grave në shtet. Veçanërisht e përhapur, sipas studimit, është dhuna psikike ndaj grave nga partnerët e tyre intimë, duke e pasur parasysh se 44% e të anketuarave kanë deklaruar se kanë qenë viktimë të dhunës së tillë. Lidhur me shqetësimin seksual, madje 30% e të anketuarave kanë thënë se pas vitit të pesëmbëdhjetë të jetës së tyre kanë qenë viktimë edhe e këtij lloji të dhunës ². Më tej, sipas konstatimeve të studimit, 14% e grave të anketuara në kuadër të hulumtimit kanë deklaruar se pasi i kanë mbushur 15 vjet, kanë përjetuar ndonjë formë të dhunës fizike apo seksuale nga partneri apo ndonjë person tjetër³.

Organizatat e shoqërisë civile në vend duke iu referuar përvojave dhe të dhënave të tyre tregojnë edhe për numrin e madh të vrasjes së grave (femicideve)⁴. Femicidet, si manifestimi më ekstrem i dhunës së burrit ndaj grave në nivel global, njihen si një prej arsyeve më të shpeshta për vdekjen e hershme tek gratë⁵. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut femicidi nuk njihet si vepër e veçantë penale në Kodin Penal dhe trajtohet si çdo vrasje tjetër. Dhuna në familjeapo dhuna e partnerit intim që i ka paraprirë veprës merret si rrethanë vështirësuese⁶.

Në pajtim me kapitullin e dytë të Konventës, e cila e vendos kërkesën kryesore për qasje holistike ndaj dhunës së grave, përveç politikave të gjera, gjithëpërfshirëse, efektive dhe të koordinuara, të vendosen edhe struktura institucionale, financiare dhe organizative. Që këtu, përveç ndryshimit të kornizës ligjore, nevojitet ndërtim i kapaciteteve të institucioneve (numri i strehimoreve që janë në dispozicion të qendrave për udhëzimin e viktimave të dhunës seksuale) dhe të punësuarit në to të kenë aftësi që të veprojnë gjatë procedurës me sensitivitet gjinor, si edhe mekanizma për ndjekjen e zbatimit të procedurave.

Kjo analizë e identifikon hendekun midis kornizës ekzistuese ligjore dhe Konventës së Stambollit, duke iu kthyer në mënyrë të veçantë nev-

² Në dispozicion në versionin elektronik në <https://www.osce.org/secretariat/419264?download=true>

³ ibid

⁴ http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2013/11/Femicidi-mk.final_.pdf

⁵ http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2013/11/Femicidi-mk.final_.pdf

⁶ ibid

ojës së rishikimit të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Duke e pasur parasysh atë se neni 6 i Konventës i angazhon shtetet nënshkruese të sigurojnë përfshirjen e perspektivës gjinore në krijimin e masave, implementimin e tyre si edhe vlerësimin e ndikimit të tyre dhe i obligon të promovojnë masa dhe të implementojnë politika të cilat kanë për qëllim ta zhvillojnë barazinë gjinore dhe t'i përforcojnë gratë⁷, kjo analizë është bërë nga perspektiva gjinore në pajtim me Nenin 6 (paragrafet 61-62).

Analiza është bërë duke e marrë parasysh se vendi ka shprehur rezerva në 5 nene. Rezerva të zbatimit në nenin 55⁸ paragrafi 1 lidhur me nenin 35 (dhunë fizike)⁹ derisa nuk harmonizohet Ligji për shkelje pa u inkriminuar me këtë rast dhuna fizike në Kodin Penal, autorët e analizës vlerësojnë se e bën implementimin e Konventës të pamundur në vend. Nuk ndodh kësisoj edhe me rezervën e nenit 44¹⁰, ku shteti e ka rezervuar të drejtën që t'i aplikojë rregullat dhe kërkesat e vendosura në Kapitullin 12 të Kodit Penal.

Njëherësh, ndërsa duke e pasur parasysh qëllimin strategjik të vendit për t'u bërë anëtare e Bashkimit Evropian, analiza e ndërthur legjislaturën evropiane e cila ka të bëjë me dhunën ndaj grave. Duke e pasur parasysh faktin që dhuna ndaj grave paraqitet në agjendën e BE-së diku nga mesi i viteve të nëntëdhjeta, me miratimin e Marrëveshjeve nga Mاستrihti dhe Amsterdami¹¹, të cilat i përforcuan institucionet evropiane

.....
⁷ Raporti shpjegues për Konventën e Stambollit, është në dispozicion në <https://rm.coe.int/16800d383a>

⁸ Neni 55 (veprime ex parte dhe ex officio) Palët sigurojnë se hetimet apo përndjekja për vepra të përcaktuara penale në pajtim me nenet 35,36,37,38 dhe 39 të kësaj Konvente, nuk do të varen tërësisht nga denoncimi apo padia e shtrua nga viktimat nëse vepra penale është kryer në tërësi apo pjesërisht në territorin e tyre dhe procedurat mund të vazhdojnë madje edhe nëse viktimat e tërheqë deklararën e saj apo denoncin.

⁹ Neni 35 (dhunë fizike) Palët i ndërmarrin masat e nevojshme ligjore apo masat e tjera që të sigurojnë se zbatimi i qëllimshëm i veprave të dhunës fizike ndaj një personi tjetër inkriminohet.

¹⁰ Neni 44 (kompetenca) paragrafi 3 „Për shkak të përndjekjes së veprave penale të përcaktuara në pajtim me nenet 36,37,38 dhe 39 të kësaj Konvente, Palët i ndërmarrin masat e nevojshme ligjore apo të tjera që të sigurojnë se kompetenca e tyre nuk është sipas kushtit të akteve të inkriminohen në territorin ku janë kryer“.

¹¹ Marrëveshja e Bashkimit Evropian e Mاستrihtit në nenin 2 e përcakton respektimin e barazisë gjinore, me çka krijohet hapësirë politike edhe për çështjet lidhur me dhunën ndaj grave. Kjo është përforcuar me Deklaratën 19 të nenit 8 të Marrëveshjes për funksionimin e Bashkimit Evropian të Romës, me të cilën vendet anëtare u obliguan ta çrrënjosin pabarazinë midis burrave dhe grave.

dhe më shumë theks i vunë të drejtave themelore të njeriut, vëllimit të legjislaturës evropiane me të cilën legjislatura maqedonase duhet të harmonizohet nuk është i madh¹². Edhe lidhur me përafrimin e legjislaturës, analiza përqendrohet veçanërisht në obligimet për vendosjen e dispozitave të përbashkëta në legjislaturën penale¹³ dhe obligimet për bashkëpunim në çështjet penale, që konsiderohet si bazë për zhvillimin e instrumenteve juridike për luftë kundër dhunës ndaj grave¹⁴.

Analiza bazohet ndaj të dhënave primare dhe sekondare. Të dhënat primare janë marrë përmes intervistave dhe hulumtimit cilësor të perceptimeve me përdorimin e metodës së diskutimeve në fokus grupet me faktorë relevantë dhe palë të involvuara. Të dhënat sekondare janë marrë përmes studimit në kabinet. Në kuadër të studimit në kabinet u shfrytëzua metoda e analizës cilësore të përmbajtjes dhe të tekstit, me ndihmën e së cilës e analizuam tekstin e Konventës së Stambollit dhe dispozitat relevante të Kodit penal që të përcaktohet shkalla e (mos) harmonizimit dhe kërkesat të cilat duhet të implementohen. Gjithashtu, në kuadër të kësaj pjese të studimit janë analizuar edhe një numër i madh i burimeve sekondare të informacioneve, të cilat përfshijnë analiza paraprake të legjislaturës, ndërsa që lidhen me implementimin e Konventës së Stambollit në Maqedoninë e Veriut, raportet e organizatave vendore dhe ndërkombëtare si edhe mendimet dhe analizat prej ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë në këtë fushë. Më pas është bërë edhe analizë juridike e Kodit Penal dhe analizë e hendekut midis këtij akti juridik, Konventës së Stambollit dhe direktivave të BE-së relevante për dhunën ndaj grave.

Studimi në terren dhe grumbullimi i burimeve primare të të dhënave u zhvillua përmes organizimit të dy fokus grupeve dhe një debati profesional në dy sesione. Fokus grupi i parë ishte me organizatat qytetare të cilat ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje, si edhe viktimat e dhunës në familje me qëllim që të përcaktohen problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen këta faktorë dhe palë të involvuara në realizimin e të drejtave të tyre. Diskutimi i dytë në grupet e fokusit ishte përbërë

.....
¹² Direktiva 2011/36/BE për parandalimin dhe luftën kundër tregtisë me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave nga tregtia me njerëz; Direktiva 2012/29/BE për minimum standartet e përbashkëta, mbështetjes dhe mbrojtjes së viktimave; Direktiva 2011/99/EY për Urdhrin evropian për mbrojtje që e përfshin edhe mbrojtjen e viktimave nga dhuna ndaj grave; Direktiva 2011/99/BE, Rregullativa (BE) nr. 606/2013 e njohjes së përbashkët të masave tona mbrojtëse për punë qytetare të cilat përfshijnë edhe masa për mbrojtjen e viktimave nga dhuna ndaj grave

¹³ Të përcaktuara me Marrëveshjen e Lisbonës

¹⁴ Kapitulli 4 i Marrëveshjes për funksionimin e Bashkimit Evropian

prej avokatëve të cilët i përfaqësojnë viktimat e dhunës në familje që i kanë identifikuar sfidat në procedurën gjyqësore gjatë mbrojtjes së viktimave. Diklutimi i tretë u organizua në dy sesione, ndërsa theksi u vendos ndryshimeve dhe plotësimeve të Kodit Penal me qëllim të harmonizimit të tij me kërkesat në dispozitat e Konventës së Stambollit. Në këto diskutime kanë marrë pjesë gjykatës, prokurorë, avokatë dhe profesorë universitarë të cilët dhanë shqyrtimin e tyre për atë se çfarë duhet të ndryshohet në Kodin Penal që të sigurohet mbrojtje më e mirë dhe më e drejtë e viktimave nga dhuna e bazuar gjinore dhe familjare.

Termt kryesor të definuar në Konventën e stambollit dhe legjislaturën e maqedonisë së veriut

Konventa e Stambollit i përkufizoi disa terme kyçe në të cilat bazohet akti: dhunën ndaj grave, dhunën në familje, gjininë, dhunën e bazuar gjinore viktimën dhe gratë. Me qëllim që të zhvillohet dhe të përpunohet strategji përkatëse për zbatimin e dispozitave të Konventës së Stambollit në Maqedoninë e Veriut, duhet të vlerësohet mënyra në të cilën do të rregullohen termet dhe konceptet që i definojnë ajo.

Çështja e dhunës ndaj grave ishte rregulluar në bazë të ligjeve të ndryshme dhe akteve nënligjore, veçanërisht në kuadër të Ligjit për familjen, ndërsa dhunën në shtëpi apo në familje deri më tani legjislatura e Maqedonisë e rregullonte me akt të veçantë në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen e dhunës në familje (LPMDFH)¹⁵ i miratuar në vitin 2014. Ky ligj i njohu termt gjini dhe dhunë të bazuar gjinore, por edhe krahas përkufizimit, nuk përdorej me to. Dhuna shtëpiake (në familje) në fillim ishte përkufizuar si dhunë në marrëdhënie familjare dhe martesore, ndërsa më pas u elaborua në kornizë të plotë politike dhe juridike e cila e përbën Strategjinë kombëtare për parandalin nga dhuna në shtëpi¹⁶ e cila ka për qëllim të vendosë sistem efektiv të mbrojtjes dhe parandalimit nga dhuna në shtëpi dhe Ligj për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje¹⁷ me të cilin u parapa kriminalizimi i dhunës në shtëpi dhe vendosi protokollre sipas të cilave vepron policia, punëtorët

¹⁵ Ligji për Parandalim dhe Mbrojtje nga Dhuna në Familje (LPMDFH), në dispozicion në <http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/Zakon%20za%20prevencija%20semejno.pdf>

¹⁶ Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje, në dispozicion në: http://www.semejnonasilstvo.org.mk/Root/mak/_docs/Nacionalna_strategija_z_a_zashtita_od_semejno_nasilstvo.pdf

¹⁷ Ligji për parandalim, ndalesë dhe mbrojtje nga dhuna në familje, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.138/2014, 33/2015, 150/2015 në dispozicion në: <http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/Zakon%20za%20prevencija%20semejno.pdf>

shëndetësorë dhe sociale në rastet e dhunës në familje¹⁸. Në vend se ta rregullojë dhunën në shtëpi si vepër të veçantë penale, Kodi penal¹⁹ e rregullon „dhunën në familje“ si faktor plotësues për nevojat e dënimit nëse ka ndodhur në të njëjtën kohë me një vepër tjetër penale, si për shembull: vrasje (neni 123); vrasje në moment (neni 125); lëndim trupor (neni 130); lëndim i rëndë trupor (neni 131); detyrim me forcë (neni 139); privim nga liria në mënyrë të paligjshme (neni 140); rrezikimi i sigurisë (neni 144); sulm seksual ndaj fëmijës i cili nuk i ka mbushur 14 vjet (neni 188) dhe ndërmjetësim në kryerjen e prostitucionit (neni 191). Më pas Kodi Penal nuk e rregullon femicidin si vepër penale, edhe pse në periudhën 2013-2016 në vend pati 15 raste të femicidit²⁰. Vrasjet e grave vetëm se janë gra zakonisht janë bërë prej partnerëve të tyre intim në shtëpinë e tyre.

Dhuna e bazuar gjinore, sipas Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (LPMDHF), nënkupton “dhunën e drejtuar kundër grave, për arsye se është grua, ose të cilën e godet pa masë”. Ky përkufizim është pak abstrakt dhe nuk e prezenton gjenezën e dhunës ndaj grave. Nëse e shikojmë përkufizimin e Blum, (2008, fq.14), *dhuna e bazuar gjinore është termi i përgjithshëm i cili e pasqyron dhunën që del si rezultat i roleve gjinore normative, bashkë me pabarazinë e sistemit të fuqisë midis dy gjinive, në kontekst të shoqërisë së dhënë; ai na tregon se burimi i dhunës është në rolet gjinore dhe stereotipat gjinore të cilat mbizotërojnë në një shoqëri. Sipas kësaj, dhuna e bazuar gjinore ka ndikim të barabartë edhe ndaj burrave edhe ndaj grave. Por, përkufizimin të cilin e përdor ligji në vend thuajse është i verbër për mundësitë dhuna e bazuar gjinore të jetë orientuar edhe ndaj burrave. Nuk ndodh kështu edhe me përkufizimin për dhunën e bazuar gjinore të cilën e përfshin Strategjia kombëtare*

.....
¹⁸ Protokoli për Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, në dispozicion në: http://www.semejnonasilstvo.org.mk/Root/mak/_docs/Protokoli_za_postapuvanje/Predlog_protokol_za_Ministerstvo_za_trud_i_socijalna_rabota_mart_2009_godina.pdf; Protokoli për Ministrinë e Punëve të Brendshme, në dispozicion në: http://www.semejnonasilstvo.org.mk/Root/mak/_docs/Protokoli_za_postapuvanje/Predlog_protokol_za_Ministerstvo_vnatreshni_raboti_noemvri_2008_godina.pdf; Protokoli për Ministrinë e Shëndetësisë, në dispozicion në: http://www.semejnonasilstvo.org.mk/Root/mak/_docs/Protokoli_za_postapuvanje/Predlog_protokol_za_postapuvanje_na_Ministerstvo_za_zdravstvo_noemvri_2008_godina.pdf Protokoli i përbashkët për veprim në rastet e dhunës në familje, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 143/15

¹⁹ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare nr. 139/2008, në dispozicion në: http://www.semejnonasilstvo.org.mk/Root/mak/default_mak.asp

²⁰ Për tre vite janë vrarë 15 gra vetëm se janë gra, “Nova Makedonija”, available online 15 femicide për 3 vjet

për barazi gjinore 2013-2020²¹ e cila u miratua në janar të vitit 2013, ndërsa që bazohet në përkufizimin e dhunës së bazuar gjinore të cilën e shfrytëzon Deklarata e KB-së për eliminimin e dhunës ndaj grave (1993), ku dhuna e bazuar gjinore përkufizohet si dhunë ndaj grave, në të cilin përfshihet çdo akt i dhunës së bazuar gjinore i cili shkakton ose është e sigurt se do të shkaktojë dëm fizik, mendor dhe seksual ose vuajtje, kanosje, shantazh dhe privime të tjera nga liria, pavarësisht nëse ndodh në opinion apo jetën private²².

Sipas përkufizimit të lartpërmendur, termi “dhunë e bazuar gjinore” në Strategjinë kombëtare fillimisht ka të bëjë me dhunën ndaj grave dhe përdoret me termin “dhunë ndaj grave”. Kjo qasje është në pajtim me Konventën e Këshillit të Evropës për parandalim dhe luftë kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, ndërsa ideja është t’i vihet theksi aspektit të shkëlqes së të drejtave të njeriut në veprën penale, me çka mundësohet qasje drejt më shumë instrumenteve juridike në luftën kundër dhunës së bazuar gjinore.

Në esencë, viktimat më të zakonshme të fuqisë së pabarabartë gjinore në shoqëri janë gratë dhe vajzat. Përveç kësaj, sipas studimit të UNFPA, gratë si viktimat të dhunës së bazuar gjinore vuajnë prej pasojave si rezultat i diskriminimit të bazuar gjinor. Edhe të dhënat e Republikës së Maqedonisë së Veriut tregojnë se gratë janë viktimat të dhunës në familje²³. Në vitin 2017 MPB i ka regjistruar 903 raste të dhunës në familje, në 93% prej tyre dhunuesi është burrë²⁴. Më të ndjeshme janë gratë si viktimat të dhunës (84% prej të gjitha viktimave të regjistruara janë gra) dhe prindërit si edhe fëmijët. Në 59% të rasteve viktimat kanë lëndime fizike, ndërsa në 37% prej tyre ekziston kanosje e sigurisë²⁵.

Duke e pasur parasysh faktin se neni 3 i Konventës së Stambollit i jep disa përkufizime të cilat aplikohen në përgjithësi në vendet të cilat syn-

²¹ Strategjia Kombëtare për Barazi Gjinore (2013-2020), në dispozicion në <http://www.mtsp.gov.mk/dokumenti.nsp>

²² Neni 1 i Deklaratës së KB-së për eliminimin e dhunës ndaj gruas, në dispozicion në: <http://www.un.org/documents/ga/res/48/a48r104.htm>

²³ Meqë në legjislaturën e Maqedonisë e rregullon vetëm dhunën në familje, data bazat e MPB-së dhe Qendrave për punë sociale grumbullojnë dhe ruajnë të dhëna betëm për dhunën në familje ndërsa jo edhe për dhunën e bazuar gjinore.

²⁴ Në 391 raste dhunuesi është bashkëshorti, në 161 raste dhunuesi është djali, ndërsa në 50 raste dhunuesi është babai.

²⁵ Të dhëna të MPB-së për vitin 2017 dispozicion në internet: http://www.mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/semeljno%20nasilstvo.pdf

ojnë t'i zbatojnë dispozitat e Konventës në kornizat ligjore kombëtare, këto përkufizime kanë rëndësi esenciale për interpretimin gjithëpërfshirës të kushteve si edhe për zbatimin e veprimit përkatës ligjor. Dhuna e bazuar gjinore në nenin 3 të Konventës së Stambollit përkufizohet me termin “dhunë ndaj grave” dhe konsiderohet si “shkelje të drejtave të njeriut dhe formë e diskriminimit ndaj grave”, si edhe “të gjitha aktet e dhunës së bazuar gjinore që rezultojnë në, ose me siguri do të rezultojnë me dëm fizik, seksual, psikologjik apo material ose vuajtje të grave, përfshirë këtu edhe kanosjet, shantazhin apo privim nga liria, pa dallim nëse ndodhin në jetën publike apo private”. Më tej, në nenin 3 dhuna e bazuar gjinore përkufizohet edhe si dhunë e cila është drejtuar ndaj grave, pasi ajo është grua dhe ndikon në mënyrë të pabarabartë ndaj saj.

Lidhur me termin kryesor viktimë, mund të thuhet se rregullohet në sistemin juridik të Maqedonisë dhe në Kodin Penal me ndryshimet dhe plotësimet në vitin 2013. Neni 122²⁶ termin „viktimë“ e përkufizon si çdo person i cili ka pësuar humbje apo dëm, duke e përfshirë edhe lëndimin fizik apo mental, vuajtjen emocionale, humbjen materiale, si edhe çdo rrezikim apo kanosje për të drejtat e saj apo të tij dhe që rezulton me vepër penale. Me këtë Kodi Penal bën dallimin midis viktimave dhe palëve të dëmtuara. Viktimat në procedurë i kanë të drejtat e tyre, si për shembull: të drejtën e informimit, mbrojtjen, ndihmën, kujdesin dhe mbështetjen, kompensimin dhe ndërmjetësimin. Sipas prof. Stojanka Mirçeva, me ndryshimin e Ligjit „viktimat e dhunës së bazuar gjinore fituan qasje drejt më shumë instrumenteve juridike në procedurën penale“²⁷. Në mënyrë plotësuese, në nenin 53 të Ligjit për Procedurë Penale²⁸ janë përcaktuar të drejtat kryesore të viktimave, në mesin e të cilave e drejta e të dëmtuarit në procedurë që i mundësohet të marrë pjesë në përndjekje apo kërkesën për kompensimin e dëmit, kujdes i veçantë dhe mbrojtje, mbrojtje nga gjykata, e drejta e ndihmës psikologjike dhe ndihmës tjetër profesionale, si edhe mbështetje prej institucioneve relevante etj. Sipas paragrafit 2, është e rëndësishme viktimat t'i gëzojnë të drejtat e tyre, ndërsa policia, prokuroria dhe gjykata kanë obligim

.....
²⁶ Neni 122, paragrafi 22 i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare e RM-së numër 80/99, numër 4/2002, numër 43/2003, numër 19/2004, numër 81/2005, numër 60/06, numër 73/06, numër 7/08, numër 139/08, numër 114/09, numër 51/11, numër 135/11, 185/11, numër 142/12, numër 166/12, numër 55/13, numër 82/13, numër 14/14, numër 27/14, numër 28/14, numër 115/14 dhe numër 132/14

²⁷ Stojanka Mirçeva, Bogdanço Gogov: Analizë e harmonizimit të legjislaturës së Republikës së Maqedonisë së Veriut me Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje: (Konventa e Stambollit): studim bazik – Shkup 2013: Lidhja e organizatave të grave të Republikës së Maqedonisë

²⁸ Neni 53 i Ligjit penal, Gazeta zyrtare e RM-së numër 150/2010

ligjor ta njoftojnë viktimën për të drejtat e veta, si edhe të veprojnë në interes të saj në vendimmarrje për përndjekjen e të akuzuarit. Ky vepër fillon menjëherë sapo viktimat ta bëjnë kontaktin e parë me sistemin juridik dhe gjyqësor, të cilët zakonisht janë policia, pastaj edhe Qendrat për punë sociale. Megjithatë, të dhënat primare prej diskutimeve në fokus grupe tregojnë se Qendrat për punë sociale zakonisht nuk shtrojnë procedura ligjore (aktakuza) para gjykatave kundër autorëve, ndërsa një prej shkaqeve është bara financiare, taksat administrative të cilat duhet t'i paguajnë, *edhe pse shuma nuk është aq e madhe që të paraqesë barë serioze financiare për institucionet*²⁹. Në interes të mbrojtjes së të drejtave të viktimave është policia të bëjë raport nga vendi i ngjarjes kur ka ndodhur dhuna. Por, sipas avokatëve, lihet anash për arsye se mbrojtësit juridik janë të pamundësuar të shtrojnë aktakuza në gjykatë për shkak të mungesë së dëshmisë, në këtë rast, raportit policor. Të drejtat e viktimave në procedurë rrezikohen edhe prej mungesës së vetëdijes dhe njohurive tek gjykatësit, veçanërisht gjykatësit meshkuj, *të cilët nuk e shohin në mënyrë objektive dhunën në familje apo atë gjinore ndaj grave, në vend se t'i zbatojnë procedurat ligjore në mënyrë të paanshme dhe sipas rregullave gjyqësore, ata shpesh angazhohen të ndërmjetësojnë në procesin e pajtimit midis partnerëve dhe këshillimin e viktimës të kthehet në shtëpi me autorin*³⁰. Në këtë kuptim nevojitet ndërtim i kapaciteteve të institucioneve për zbatimin e të drejtave të viktimave por edhe në përgjithësi për ngritjen e vetëdijes për Konventën e Stambollit që të mundësojnë zbatimin, por edhe t'i referohen Konventës gjatë interpretimit të legjislaturës kombëtare në pajtim me Konventën³¹.

Kodi Penal dhe legjislatura tjetër tërësisht janë të verbra lidhur me termin gjini. Përveç përkufizimit të gjinisë si bazë për diskriminimin, gjinia nuk është aspak e rregulluar as me Kodin Penal, e as me Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna familjare. Mosnjohja e gjinisë pamundëson që të njihen rrethanat dhe gjeneza e dhunës ndaj grave që del prej roleve gjinore. Akoma më shumë, Kodi Penal është tërësisht i verbër për gratë. Kodi përdor terma në denominimin e meshkujve si neutral apo që vlejnë për dy gjinitë dhe nuk njeh burra dhe gra, edhe pse në një pjesë të mirë prej veprave penale të cilat i rregullon njohja mund të sigurojë mbrojtje më të mirë dhe realizim të të drejtave të viktimave të dhunës si edhe implementim efektiv të Konventës së Stambollit. Kjo

²⁹ Dikutim në fokus grupin e mbajtur më 17.07.2018, i cili përbëhej prej përfaqësuesve dhe avokatëve të viktimave, të cilët i theksuan mangësitë në sistem kur bëhet fjalë për mbrojtjen e viktimave dhe sigurimi i ndihmës për ta është përndjekje penale e autorit

³⁰ Ibid

³¹ CEDAW/C/ MKD/CO/4-5, para. 9 dhe CEDAW/C/MKD/CO/6, p.10

është në pajtim edhe me rekomandimet e Raportit të gjashtë periodik të Komitetit për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave³², në të cilin thuhet se shteti duhet t'i rishikojë të gjitha dispozitat gjinore neutrale në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në shtëpi dhe Kodin Penal dhe të garantojë përfshirjen e dimensionit gjinor në procedurat për zbatimin e të drejtës me të cilën rregullohet dhuna në shtëpi.

2.1 Drejt politikës së plotë për dhunën kundër grave – perspektiva krahasuese nga Ballkani Perëndimor

Vlerësimi kryesor i GREVIO³³ për zbatimin e Konventës tregon për trendin e miratimit të planeve vepruese kombëtare në të cilat titulli përmendet se përfshin politika për dhunën e bazuar gjinore, ndërsa ato *de facto* fokusohen në mënyrë ekskluzive dhe primare në dhunën në shtëpi apo familje³⁴. Shqipëria është shembull i tillë. Raporti i GREVIO³⁵ për Shqipërinë përcakton se vendi e përfshin qasjen sensitive gjinore duke e njohur dhunën në shtëpi (familje) si diskriminim i bazuar gjinor dhe i lidh politikat dhe masat për dhunën ndaj grave me masat të cilat promovojnë barazi gjinore dhe përforcim të grave. Në këtë mënyrë, dy tipat e masave janë zhvilluar në bazë të strategjive dhe planeve vepruese të cilat kanë të bëjnë me diskriminimin dhe dhunën ndaj grave si problem i vetëm i politikës publike³⁶. Ky dualizëm vlerësohet si efektiv për zbatimin e Konventës, veçanërisht nga aspekti i nenit 6 prej saj, por vlerësimi i masave nga aspekti i rezultateve të tyre tregon se ato shumë janë të fokusuara në dhunën në shtëpi³⁷, derisa format e tjera të dhunës ndaj grave, si për shembull: martesa e detyruar, aborti i detyruar, dhuna seksuale, përfshirë edhe përdhunimin dhe shqetësimin seksual, nuk janë vënë prioritete në krijimin e as në implementimin e masave .

.....
³² Vërejtje përfundimtare, 2018 CEDAW/C/MKD/CO/6, p.24

³³ Një grup ekspertësh për veprim kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në shtëpi e ndjek zbatimin e kësaj Konvente prej Palëve.

³⁴ Sektori për politika publike dhe të drejta qytetare dhe çështje kushtetuese të Parlamentit Evropian, me kërkesë të komitetit FEMM, Të drejtat e grave në Ballkanin Perëndimor, 2019

³⁵ GREVIO (2018b). GREVIO Raporti kryesor për vlerësim – Shqipëri, op.cit.

³⁶ Ibid.

³⁷ Ibid.

Për dallim prej Shqipërisë, Bosnjë e Hercegovina zhvilloi Strategji për implementimin e Konventës në vitin 2015³⁸ me qasje të plotë në parandalimin e dhunës ndaj grave, jo vetëm dhunës në shtëpi. I tillë nuk është rasti me Kosovën, e cila në vitin 2017 gjithashtu solli Strategji kombëtare e cila ka të bëjë vetëm me dhunën në shtëpi (familje), duke përfshirë masa dhe aktivitete dhe institucionet përgjegjëse për implementim, si edhe duke identifikuar mekanizëm të qartë koordinues³⁹. Mali i Zi gjithashtu e ka aprovuar Strategjinë për mbrojtjen e dhunës në shtëpi (familje) (2016-2020).⁴⁰ Por, edhe pse titulli ka të bëjë me dhunën në shtëpi (familje), vlerësimi i GREVIO⁴¹ është se ajo e përmban përkufizimin e dhunës së bazuar gjinore të harmonizuar me nenin 3 të Konventës dhe masat dhe aktivitetet të cilat janë vetëm në kontekstin familjar dhe prandaj nuk paraqet dokument të plotë politik i cili ka të bëjë me të gjitha llojet e dhunës kundër grave⁴². Serbia nuk ka strategji për dhunën kundër grave. Plani veprues kombëtar i Republikës së Maqedonisë së Veriut i përfshin tre kategori të masave dhe aktiviteteve: (i) legjislativën – që lidhet me harmonizimin e legjislaturës për të gjitha format e dhunës së përcaktuar me Konventën; (ii) parandalimin – që lidhet me shërbimet parandaluese të cilat duhet të bazohen që të pengohen të gjitha llojet e dhunës kundër grave dhe (iii) mbrojtjen – që lidhet me standardet për shërbime të specializuara për viktimat e dhunës së bazuar gjinore. Plani veprues parasheh mbështetje financiare për zbatimin e masave të UN-WOMEN, UNDP dhe donatorëve të tjerë, si edhe mjetet e Qeverisë dhe të Vetëqeverisjes Lokale. Megjithatë, plani nuk ofron vlerësim konkret se sa do të kushtojë secila prej masave. Derisa plani i identifikon institucionet të cilat janë të obliguara për implementimin e masave, ai nuk parasheh informacion për atë se cili institucion do të jetë i obliguar për koordinimin e implementimit, edhe pse Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka formuar grup ndërsektorial për implementimin e Konventës.

.....
³⁸ Qëllimet e Strategjisë kornizë për zbatimin e Konventës për mbrojtje dhe luftë kundër dhunës ndaj gruas dhe dhunës në familje të Këshillit të Evropës (2013-2018) në BeH janë: 1. Të sigurohet mbrojtje gjithëpërfshirëse, efektive dhe inkluzive nga dhuna ndaj gruas dhe dhuna në familje. 2. Të vendosë sistem multidisiplinor dhe koordinues për mbrojtjen e viktimave prej dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në pajtim me Konventën e Stambollit. 3. T'i përforcojë kërkesat për sanksionimin e autorëve të dhunës ndaj grave dhe monitorimin e politikave sensitive integruese dhe gjinore për mbrojtje dhe parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Tërkulja 2018)

³⁹ Raport vlerësues i Programit kosovar kundër dhunës në shtëpi dhe Plan veprues(2011-2014) në Krasniqi (2018)

⁴⁰ Rajçeviq (2018), op.cit.

⁴¹ GREVIO (2018b). GREVIO Raport vlerësues kryesor – Mali i Zi op.cit.

⁴² Ibid.



2.2 Konstatime për përkufizimin e termave kryesor me Konventën e Stambollit

Siç është dhënë në nenin 1 të Konventës së Stambollit, ajo ka për qëllim t'i mbrojë gratë dhe t'i eliminojë të gjitha format e dhunës dhe diskriminimit për promovimin e barazisë midis grave dhe burrave, përf forcimin e grave. Prandaj, legjislatura kombëtare duhet ta trajtojë këtë çështje të diskriminimit dhe pabarazisë së bashku me çështjen e dhunës ndaj grave. Diskriminimi, rolet gjinore dhe stereotipat e përcaktojnë bazën, gjenezën e paraqitjes dhe prevalencës së sjelljes së dhunshme drejtuar nga gratë pasi janë gra. Që të parandalohet dhuna ndaj grave, nevojitet intervenim i koordinuar dhe gjithëpërfshirës për parandalimin e diskriminimit dhe kriminalizimin e të gjitha llojeve të dhunës ndaj grave. Që këtu, është e barabartë **Kodi Penal t'i përkufizojë të gjitha format e dhunës ndaj grave si vepër penale, por njëherësh i përkufizon edhe termin gjini, ta rishikojë gjuhën prej neutral gjinor në përgjegjësi gjinor dhe t'i njohë gratë si subjekte por edhe viktime të sjelljes së dhunshme.** Përveç kësaj, me vendosjen dhe përkufizimin e kushteve të Kodit Penal, vëllimi i veprës penale do të intensifikohet, me çka do të sigurojë qasje drejt instrumenteve juridike më efikase për luftë kundër dhunës gjinore.

Në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, i cili hyri në fuqi në vitin 2014, ekziston përkufizim për dhunën e bazuar gjinore që është në pajtim me Konventën e Stambollit. Megjithatë i gjithë Ligji është

i fokusuar në dhunën familjare dhe me atë vetëm pjesërisht e mundëson zbatimin e konventës. Që këtu, **nevojitet zgjerim i vëllimit të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen prej dhunës në familje apo zëvendësimin e tij me ligj të ri i cili do t'i rregullojë të gjitha format e dhunës së bazuar gjinore.** Në këtë mënyrë do të viheshin procedurat kryesore për veprim me viktimat prej të gjitha formave të dhunës ndaj grave, do të rregullohet bashkëpunimi midis institucioneve, si edhe grumbullimi dhe ruajtja e të dhënave të ndara në aspektin gjinor me dhunën ndaj grave. Përmes këtij intervenimi politik, Republika e Maqedonisë së Veriut i përgjigjet rekomandimit të përgjithshëm numër 35 (2017) për dhunën e bazuar gjinore ndaj grave, i cili e plotëson rekomandimin numër 19 (1992) për dhunë ndaj grave. Në mënyrë paralele vendi u përgjigjet rekomandimeve të CEDAW për ta bërë prioritar miratimin e legjislaturës e cila ka të bëjë me të gjitha format e dhunës së bazuar gjinore⁴³.

Që këtu, nevojitet edhe harmonizim i Kodit Penal me Konventën e Stambollit dhe Ligjin e ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna e bazuar gjinore . Nevojitet **përkufizim i dhunës së bazuar gjinore apo vetëm dhunës prej grave në Kapitullun trembëdhjetë – rëndësia e shprehjeve të këtij kodi neni 122 me zëvendësimin e përkufizimit për dhunën familjare.** Përkufizimi në Kodin Penal për “dhunën ndaj grave” duhet ta përfshijë edhe dhunën ekonomike ⁴⁴ që t'i shënojë të gjitha aktet e dhunës së bazuar gjinore të cilat çojnë ose me siguri do të çojnë drejt lëndimit apo vuajtjes fizike, seksuale psikike dhe ekonomike apo vuajtjes së grave, duke përfshirë edhe kanosje për akte të tilla, shantazh apo privim nga liria, pavarësisht nëse ndodhin në jetën publike apo private në pajtim me nenin 3 të Konventës së Stambollit. Këto dispozita janë me qëllim që të sigurohet mbrojtje më e madhe për viktimat në të gjitha nivelet e veprimit.

Nevojitet edhe **përfshirja e përkufizimit për gjininë, si edhe plotësimi i përkufizimit për viktimën me qëllim të njohjes së gruas si viktimë e dhunës së bazuar gjinore.** Kjo është veçanërisht e rëndësishme për ngritjen e vetëdijes, ndërtimin e kapaciteteve të cilat do të mundësojnë implementimin e Konventës së Stambollit, veçanërisht për arsye se në ligjet kombëtare apo aktet nënligjore nuk ka përkufizim të “gjinisë”.

.....
⁴³ Raporti periodik i gjashtë i Komitetit për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave, Vërejte përfundimtare, 2018, p. 24 në dispozicion në internet: https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW/C/MKD/CO/6&Lang=En

⁴⁴ *Vlerësimi I ndikimit midis marrëveshjes ndërkombëtare dhe legjislaturës vendore, i për-gatitur nga prof. Tërpe Stojanovski dhe Iskra Andreeva*

Përfundimisht, lidhur me harmonizimin e termave kryesorë të cilat i përdor Konventa e Stambollit, nevojitet në Kodin Penal të zëvendësohet përdorimi i “dhunës familjare” me “dhunë të bazuar gjinore dhe dhunë në shtëpi”, si edhe zbatimi përkatës i termit më të ngushtë “dhunë ndaj gruas” si faktorë plotësues për nevojat e dënimit nëse ndodh kjo në të njëjtën kohë me një vepër penale tjetër, si për shembull: vrasje (neni 123); vrasje në moment (neni 125); lëndim trupor (neni 130); lëndim trupor i rëndë (neni 131); detyrim (neni 139); privim i paligjshëm nga liria (neni 140); rrezikimi i sigurisë (neni 144); sulm seksual ndaj një fëmije i cili nuk i ka mbushur 14 vjeç (neni 188) dhe ndërmjetësim në ushtrimin e prostitucionit (neni 191).

Kodi penal dhe format e ndryshme të dhunës ndaj grave

Konventa e Stambollit është instrumenti i parë i obligueshëm juridik në Evropë i cili i vendos standardet në sferën e parandalimit, mbrojtjes së viktimave, përndjekjes dhe dënimit të autorëve dhe e paraqet marrëveshjen ndërkombëtare më efektive me të cilën mund të parandalohet dhuna ndaj grave. Konventa thekson se dhuna ndaj grave është e rrënjësor thellës në pabarazinë midis burrave dhe grave. Bazohet në qasjen të cilën e njohim si “4P” apo katër shtyllat: parandalimi (Prevention), përndjekja (Prosecution), mbrojtja (Protection) dhe politika integruese (Policies). Përveç se është dokument gjithëpërfshirës, Konventa e Stambollit është instrument efektiv i cili kërkon prej vendeve nënshkruese të sigurojnë drejtësi penale adekuate për të gjitha format e dhunës ndaj grave; dhe për arsye se kërkohet ballafaqim me rrënjën e shkaqeve për dhunën ndaj grave (stereotipat gjinore, traditat me të cilat janë të dhunshëm ndaj grave dhe të gjitha manifestime e përgjithshme të pabarazisë gjinore) ⁴⁵.

Tërpe Stojanovski dhe Iskra Andreeva në Vlerësimin e ndikimit të Konventës së Stambollit ndaj legjislaturës së Maqedonisë rekomandojnë përgatitjen dhe sjelljen e një Ligji të ri për parandalimin dhe mbrojtjen e dhunës së bazuar gjinore, i cili në tërësi dhe në mënyrë të qartë do t'i shprehë qëllimet, vëllimin e zbatimit, obligimet dhe masat e parapara në Konventë. “Por, duke e pasur parasysh faktin se praktika nomoteknike përfshin edhe parashikimin e veprave penale edhe me ligj të veçantë dhe jo me Kodin Penal, duke e pasur parasysh zhvillimin e të drejtës penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përvojat me rregullimin e veprave penale të reja dhe zbatimin e dispozitave ligjore, rekomando-

⁴⁵ GREVIO (2017a). GREVIO Baseline Evaluation Report – Austria. Strasbourg: Council of Europe.

het veprat penale të cilat janë paraparë me Konventë të rregullohen në mënyrë përkatëse në Kodin Penal”⁴⁶

Për momentin Kodi Penal në Republikën e Maqedonisë së Veriut („Gazeta zyrtare“ nr. 37/1996; 80/1999; 4/2002; 43/2003; 19/2004; 81/2005; 60/2006; 73/2006; 7/2008; 139/2008, 114/2009, 51/2011; 135/2011; 185/2011; 142/2012; 166/2012; 55/2013; 82/2013; 14,27,28, 115, 132, 160,190/2014; 196/2015) e kriminalizon vetëm dhunimin. Format e tjera të dhunës ndaj grave të rregulluara me nenet 33, 34, 35, 36, 37, 38 dhe 39 të Konventës së Stambollit në janë rregulluar në mënyrë eksplicite me Kodin Penal. Disa prej këtyre formave të dhunës janë rregulluar pjesërisht si delikte me ligje të reja si për shembull Ligjin për familjen (martesën e detyruar), Ligjin për mbrojtje dhe parandalim nga diskriminimi, Ligjin për marrëdhënie pune (shqetësimi seksual në vendin e punës), Ligjin për ndërprerjen e shtatzënisë (abortin e detyruar dhe sterilizimin) etj.

3.1 Dhuna psikike dhe fizike në Konventën e Stambollit (neni 33 dhe neni 35)

Konventa e Stambollit në nenin 33 thotë “Palët i ndërmarrin masat e nevojshme ligjdhënëse dhe të tjera që të sigurojnë se sjellja e qëllimshme e cila në mënyrë serioze e shkel apo lëndon integritetin psikik të ndonjë personi me përdorimin e detyrimit apo kanosjes inkriminohet”. Më pas Konventa e mbron integritetin psikik të personit, ndërsa e kriminalizon sjelljen e cila përdor detyrimin apo kanosjen.

Kodi Penal i Maqedonisë nuk e njeh veprën penale dhunë psikike si vepër më vete. Ai e përmend në përkufizimin e dhunës në familje në nenin 122 paragrafi 1 *Nën dhunë familjare nënkuptohet tortura, ofendimi i ashpër, rrezikimi i sigurisë, lëndimi trupor, dhuna gjinore apo tjetër **psikike** apo fizike me të cilën shkatohet ndjenja e pasigurisë, rrezikimit, frikës, ndaj bashkëshortëve, prindërve apo fëmijëve apo personave të tjerë të cilët jetojnë në bashkësi martesore apo jomartesorë apo në amvisëri të përbashkët, si edhe ndaj ish-bashkëshortëve apo personave të cilët kanë fëmijë të përbashkët apo janë në marrëdhënie personale të afërta.* Për fat të keq, integritetin psikik të cilin Konventa e përkufizon se shkellet me veprën

.....
⁴⁶ Plani veprues për zbatimin e konventës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në shtëpi i Republikës së Maqedonisë së Veriut 2018-2023, në dispozicion në Plani veprues për zbatimin e konventës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në shtëpi i Republikës së Maqedonisë së Veriut 2018-2023



përmes përdorimit të detyrimit apo kanosjes askund nuk përmendet në legjislaturën e Maqedonisë së Veriut. Duke e pasur parasysh faktin që praktika tregon se dhunës fizike gjithmonë i paraprin dhuna psikologjike, me përkufizimin e qartë të veprës dhe kriminalizimin do të ndikohet në uljen e trendit të dhunës fizike dhe përfundimisht ndaj femicideve në vend⁴⁷.

Që këtu, rregullimi i veprës detyrim në nenin 139⁴⁸ nuk është i ma-jftueshëm. Objekt i mbrojtjes së veprës penale detyrim është liria e formimit të vullnetit për ndonjë veprim të caktuar, ndërsa Konventa e Stambollit kërkon mbrojtje të integritetit psikik të personalitetit. “Për dallim prej formës kryesore të veprës, kur për përndjekje ndërmerret padi

.....
⁴⁷ Elena Dimushevska (2018), në “Analizën e rasteve të femicideve – vrasjes së grave në Republikën e Maqedonisë” të Rrejtit kombëtar kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje – Zëri kundër dhunës përcakton se në periudhën prej 01.01.2008 deri më 31.12.2016 prej gjithsej 70 grave të vrara sipas të dhënave të Entit Shtetëror për Statistikë, 53 jano femicide, gjegjësisht vrasje e grave vetëm se janë gra (në dispozicion në internet Elena Dimushevska (2018): http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2013/11/Femicidi-mk.final_.pdf).

⁴⁸ Detyrimi (1) Ai që me detyrim ose me kanosje serioze do të detyrojë një tjetër të kryejë ose durojë diçka, do të ndëshkohet me dënim në të holla pse me burg deri në një vit. (2) Nëse vepra prej paragrafit 1 është kryer gjatë dhunës në familje, autori do të dënohet me burg prej gjashtë muajsh deri në tre vjet. (3) Nëse veprën prej paragrafit 1 e kryen person zyrtar gjatë kryerjes së detyrës, do të dënohet me burgim me burg prej gjashtë muajsh deri në pesë vjet.

penale, formë e kualifikuar ekziston gjatë kryerjes së dhunës në familje dhe përndiqet me detyrë zyrtare.”⁴⁹

Gjithashtu rregullimi i kanosjes pjesërisht me nenin 144 – rrezikimi i sigurisë⁵⁰ nuk është i mjaftueshëm. Kjo dispozitë e sanksionon shkaktimin e ndjenjës së pasigurisë, rrezikimit apo frikës me kanosje serioze se do të bëhet ndaj jetës dhe trupit të personit ose personit të afërt me të. Nëse vepra është kryer gjatë kryerjes së dhunës në familje, konsiderohet si rrethanë kualifikuese dhe dënimi i paraparë për autorin është më rigoroz, ndërsa përndjekja ndërmerret me detyrë zyrtare. Megjithatë, lidhja e kanosjes me rezultatet – çrregullimi i integritetit psikik nuk bëhet dhe në këtë kuptim nevojitet harmonizim me Konventën e Stambollit.

Që këtu nevojitet të futet edhe një vepër e re penale në KP, “Dhunë psikike”, në pajtim me dispozitat e Konventës⁵¹ Kjo kërkohet edhe më shumë pasi statistika penale gjyqësore udhëhiqet sipas një neni të veprës penale. Kjo do të thotë se nëse nuk rregullohet dhuna psikike si vepër penale e veçantë, nuk mund të udhëhiqet statistikë dhe të grumbullohen të dhëna për zbatimin e Konventës së Stambollit. Ajo që dhuna në familje (ose nëse harmonizohet KP dhe përdoret termi dhunë e bazuar gjinore) është marrë si faktor i cili ndikon, e kualifikon veprën, gjithashtu nuk e lejon implementimin e nenit 11 të Konventës i cili i obligon vendet nënshkruese për intervale të rregullta të grumbullojnë dhe njoftojnë për të gjitha format e dhunës ndaj grave pasi grumbullimin i të dhënave nga MPB dhe organet gjyqësore është sipas nenit të Kodit Penal, dhe jo sipas nenit (dhuna në familje si element kualifikimi të vepërs gjithmonë

.....
⁴⁹ Stojanka Mirçeva, Bogdanço Gogov: Analizë e harmonizimit të legjislaturës së Republikës së Maqedonisë së Veriut me Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në shtëpi: (Konventa e Stambollit): studim bazik – Shkup 2013: Lidhja e organizatave të grave të Republikës së Maqedonisë.

⁵⁰ (1) Ai që do ta rrezikojë sigurinë e një tjetri me kanosje serioze se do të sulmojë ndaj jetës së tij ose trupit ose jetës ose trupit të një personi të tij të afërt, do të dënohet me dënim në të holla ose me burg deri në gjashtë muaj. (2) Ai që do ta kryejë veprën e paragrafit 1 gjatë kryerjes së dhunës në familje, do të dënohet me burg prej tre muaj deri në tre vjet. (3) Me dënimin e paragrafit 2 do të dënohet ai që veprën e paragrafit 1 do ta kryej ndaj personit zyrtar në kryerjen e shërbimit apo ndaj më shumë personave. (4) Ai që përmes sistemit informatik do të kanoset se do të kryejë vepër penale për të cilën është rregulluar dënim me burg prej pesë vitesh ose dënim më i rëndë ndaj një personi për shkak të përkatësisë së tij ndaj përkatësisë së caktuar kombëtare, etnike apo grupi rasor ose përcaktimi fetar, do të dënohet me dënim me burg prej një deri në pesë vjet. (5) Përndjekja e veprës prej paragrafit (1) ndërmerret me padi private.

⁵¹ Tërpe Stojanovski dhe Iskra Andreeva, *Vlerësimi për ndikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndaj legjislaturës vendore, dokument i brendshëm*

përmendet në paragrafin e dytë, që e pamundëson grumbullimin e të dhënave).”Më pas, grumbullohen të dhëna të shpërndara vetëm për autorët e veprave penale, dhe jo edhe për viktimat⁵². Me përkufizimin e veprës penale si të veçantë, dhunë psikike, shteti i përgjigjet pritshmërive të Bashimit Evropian për t’i përmirësuar dhe harmonizuar të dhënat administrative për dhunën ndaj grave të cilat paraqesin vështirësi që të grumbullohen në territorin e të gjithë Unionit për shkak të metodologjive të ndryshme për grumbullim të cilat përdoren tek çdo vend anëtar dhe kandidat për anëtarësim në Union⁵³.

“ Konventa e Stambollit në nenin 35 e i rregullon “palët t’i ndërmarrin masat e nevojshme ligjdhënëse dhe të tjera për të siguruar se kryerja e qëllimshme e vprave të dhunës fizike ndaj një personi tjetër inkriminohet.”

Kodi Penal i Maqedonisë së Veriut nuk e rregullon dhunën fizike si vepër penale të veçantë por e përfshin në përkufizimet e dhunës në familje, në nenin 122 paragrafi 21 *“Nën dhunë familjare nënkuptohet tortura, ofendimi i madh, rrezikimi i sigorisë, lëndimi trupor, gjinor apo një dhunë tjetër psikike apo **fizike** me të cilën shkaktohet ndjenja e pasigurisë, rrezikimit*

.....
⁵² Stojanka Mirçeva, Bogdančo Gogov: Analiza e harmonizimit të legjislaturës së Republikës së Maqedonisë së Veriut me Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje: (Konventa e Stambollit): studim bazik – Shkup 2013: Lidhja e organizatave të grave të Republikës së Maqedonisë

⁵³ EIGE 2015, Strategic framework on violence against women (2015-2018), available online: <https://eige.europa.eu/rdc/eige-publications/strategic-framework-violence-against-women-2015-2018>



*apo frikësn ndaj partnerit, prindërve dhe fëmijëve ose personave të tjerë të cilët jetojnë në bashkësi martesore apo jashtëmartesore apo në amvisëri të njëjtë, si edhe ndaj ish-partnerit apo personave të cilët kanë fëmijë të përbashkët ose ndodhen në marrëdhënie të afërta personale". Kodi penal gjatë rregullimit të veprave penale "Lëndim trupor" neni 130⁵⁴ dhe „Lëndim i rëndë trupor“ neni 131⁵⁵, si edhe në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje. Tek inkriminimet e lartpërmendura, objekt i mbrojtjes është jeta dhe integriteti trupor. Megjithatë, rregullimi i dhunës në familje si element i kualifikuar të veprave penale ku fuqia fizike ndaj jetës dhe integritetit trupor të viktimës nuk është e lejuar prej dy arsyeve. Fillimisht, nuk tregon për gjenezën e dhunës gjegjësisht të pabarazisë gjinore, rolet gjinore dhe stereotipat të cilat kanë çuar drejt trupit të viktimave të dhunës në familje. Për këtë nevojitet ndryshim i termit dhunë në familje në dhunën e bazuar gjinore. Së dyti, me rregullimin e dhunës në familje si element kualifikuar i veprës në cilindo prej qëndrimeve më të poshtme mundëson grumbullim të të dhënave për veprën, që paraqet pengesë serioze për implementimin e Konventës së Stambollit, veçanërisht neni 11, i cili ka të bëjë me grumbullimin e të dhënave dhe njoftimin për të gjitha format e dhunës. **Prandaj nevojitet të futet vepër e re penale në KP, "Dhunë fizike", në pajtim me dispozitat***

⁵⁴ (1) Ai që e lëndon një tjetër në trup ose që do t'i shkaktojë probleme shëndetësore, do të dënohet me dënim me para ose me burg deri në tre vjet. (2) Ai që do ta kryejë veprën e paragrafit 1 gjatë kryerjes së dhunës në familje, do të dënohet me dënim me burg prej gjashtë muaj deri në tre vjet (3) Gjykata mundet autorit të veprës së paragrafit 1 t'i shqitojë vërejtje gjyqësore nëse është shkaktuar me sjellje ofenduese ose të ashpër ndaj të dëmtuarit. (4) Përndjekja për veprën e paragrafit 1 ndërmerret me padi penale, ndërsa për paragrafin 2 me propozim

⁵⁵ (1) Ai që do të lëndojë një tjetër rënd në trup ose që do t'i shkaktojë probleme shëndetësore, do të dënohet me burg prej gjashtë muaj deri në pesë vjet. (2) Ai do ta kryejë veprën e paragrafit 1 gjatë kryerjes së dhunës në familje, do të dënohet me dënim me burg prej një deri në pesë vjet (3) Ai që do t'i shkaktojë tjetrit lëndime të rënda trupore ose do t'i shkaktojë probleme shëndetësore dhe për at do të vihet në rrezik jeta e të lënduarit se do t'i shkatërrohet ose përjetësisht ose në masë të konsiderueshme dobësohet ndonjë pjesë e rëndësishme e trupit ose ndonjë organ kryesor ose që do të shkaktohet paaftësi e përhershme për punën në përgjithësi ose për punën për të cilën është aftësuar ose do t'i përkeqësohet shëndeti përherë ose rëndë do t'i çrregullohet shëndeti i tij, do të dënohet me burg prej një deri në dhjetë vjet. (4) Nëse për shkak të një lëndimi të rëndë trupor të paragrafëve prej 1 deri në 3 i lënduar vdes, autori do të dënohet me dënim me burg prej së paku një viti. (5) Ai që veprën e paragrafëve 1 dhe 2 do ta kryej nga pakujdesia, do të dënohet me dënim në të holla ose me burg deri në tre vjet. (6) Ai që veprën do ta bëjë në moment, pa fajin e tij në gjendje të acarimit të ashpër me sulm ose me ofendim të rëndë ose si pasojë e dhunës në familje nga i lënduari, do të dënohet për veprën e paragrafëve 1 dhe 2 me dënim në të holla ose me burg deri në tre vjet, ndërsa për veprën e paragrafëve 3 dhe 4 me burg prej një deri në pesë vjet

e Konventës dhe të bëhet konsolidim me dispozitat tashmë ekzistuese në KP, ndërsa të cilat kanë të bëjnë me vepra të tjera penale⁵⁶.

3.2 Dhuna seksuale dhe përdhunimi (neni 36)

Shqetësimi seksual është rregulluar me nenin 36 të Konventës së Stambollit, me të cilin vendet nënshkruese obligohen t'i kriminalizojë të gjitha format e marrëdhënieve seksuale pa pajtim. Konventa jep përshkrim të thuktë për atë se cilat vepra seksuale duhet të kriminalizohen. Në radhë të parë thuhet se këto vepra përfshinin aktet me penetrimin vaginal, anal ose gojor të natyrës seksuale pa pëlqim në trupin e një personi tjetër me cilëndo pjesë të trupit të njeriut ose me ndonjë objekt. Më pas, në pjesën b. Konventa e rregullon përfshirjen e çdo marrëdhënie tjetër seksuale pa pëlqimin e personit të tretë. Me pjesën e fundit, qëllimi është të mbulohen edhe lidhjet e dhunshme, në të cilat njëri prej partnerëve detyrohet për marrëdhënie seksuale me palën e tretë, të zgjedhur nga autorët e veprës penale.

Në paragrafin 2 të nenit 36 vazhdon të përkufizohet se çfarë do të thotë pëlqimi dhe thuhet se ai duhet të jetë vullnetar, që do të vlerësohet në kontekst të rrethanave nën të cilat është dhënë. Kështu, elementi kryesor në përkufizimin e dhunës seksuale, duke e përfshirë edhe përdhunimin, është pëlqimi. Kjo do të thotë se pa vullnetin e lirë ndërmarrja e aktiviteteve seksuale duhet ndëshkuar. Ky ndryshim i rëndësishëm në paradigmen paraprake, kur përdorimi i forcës ishte element i cili aktin seksual e konsideronte si të dhunshëm.

Paragrafi i obligon palët t'i ndërmarrin të gjitha masat e domosdoshme juridike dhe të tjera për t'i zbatuar dispozitën e paragrafit 1 për të gjitha format e marrëdhënieve seksuale pa pëlqim, pa dallim se cila është lidhja midis autorit dhe viktimës, duke i përfshirë edhe marrëdhëniet me ish-partnerin si edhe atë aktual të njohura nën të drejtën e brendshme.

Në sistemin juridik të Maqedonisë së Veriut, forma të ndryshme të delikteve seksuale dënohen me ligje të ndryshme. Megjithatë, duhet të përmendet se terminologjia e cila përdoret në sistemin juridik të Maqedonisë është pak më ndryshme se ajo në Konventën e Stambollit, ku përdoret termi dhunë seksuale. Në legjislaturën e Maqedonisë përdoret termi “dhunë gjinore”, i cili rrjedh nga fjala “gjinia” (gjinia, karakteristikat biologjike të cilat e përcaktojnë dikë si grua apo burrë).

.....
⁵⁶ Tërpe Stojanovski dhe Iskra Andreeva: *Vlerësimi për ndikimin e marrëveshjes ndërkombëtare mbi legjislaturën vendore.*

3.2.1 FORMAT E DHUNËS SEKSUALE NË LEGJISLATURËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Ligjet të cilat e rregullojnë dhe inkriminojnë formën e ndryshme të dhunës seksuale janë: Kodi Penal, Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen e dhunës në familje, Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe Ligji për marrëdhënie pune. Kodi Penal i Maqedonisë e rregullon dhunën si vepër penale, e cila është rregulluar në Kapitullin XIX – Vepra penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor. Më konkretisht, sipas nenit 186⁵⁷, përdhunimi konsiderohet vepër penale. Kjo vepër, sipas dispozitës së Ligjit, përfshin përdorimin e forcës apo trajtimin, si edhe luajtjen me nderin dhe dinjitetin e viktimës apo ndonjë personi tjetër të afërt. Sa i përket sanksionimit të autorëve, paragrafi 1 i nenit të njëjtë 186 parasheh burgim prej tre deri në dhjetë vjet. Marrëdhënia midis autorëve dhe viktimës në raste të tilla është relevante, që do të thotë se intimiteti dhe shkalla e afërsisë nuk e përjashtojnë prokurorinë, që ndodh me detyrë zyrtare⁵⁸.

Sulmin seksual ndaj personave të pafuqishëm, si dhe llojet e tjera të deliktit seksual, neni 187 i Kodit Penal këtë akt e njeh si vepër penale. Sipas kësaj, në paragrafin 1 thuhet se çdo person i cili e sulmon seksualisht një person tjetër, duke e shfrytëzuar sëmundjen e tij apo të saj mendore ose çrregullimin mendor, zhvillimin mental të ngecur ose ndonjë gjendje tjetër me të cilën ai person nuk mund të kundërshtojë, do të dënohet me burg prej tre muaj deri në pesë vjet.

Një formë tjetër e deliktit seksual që rregullohet dhe ndëshkohet me Kodin Penal në nenin 188 është sulmi gjinor ndaj një fëmije që nuk i ka

.....
⁵⁷ (1) Ai që me përdorimin e forcës apo kanosjes se drejtpërdrejt do të sulmojë trejtin ndaj jetës së tij apo trupit apo ndaj jetës apo trupit të një personi të afërt të tij, do ta detyrojë në përdhunim, do të dënohet me burg prej tre deri në dhjetë vjet. (2) Nëse për shkak të veprës së paragrafit 1 ka ndodhur lëndim i rëndë trupor, vdekje apo pasoja të tjera të rënda ose vepra e kryer nga më shumë persona apo në mënyrë mjaft mizore apo dëshpëruese, autori do të dënohet me burg prej të paktën katër vjet. (3) Ai që do ta detyrojë një tjetër për marrëdhënie seksuale me kanosje serioze se për të apo për një person të afërt të tij/saj do të zbulojë diçka që do t'ia dëmtonte nderin dhe dinjitetin se do të shkaktojë një të keqe tjetër të rëndë, do të dënohet me burg prej gjashtë muaj deri në pesë vjet. (4) Ai që në rastet e paragrafëve 1, 2 dhe 3 do të kryej vetëm një veprim tjetër seksual, do të dënohet për veprën e paragrafit 1 me burg prej gjashtë muaj deri në pesë vjet, për veprën e paragrafit 2 me. Burg prej një deri në dhjetë vjet, ndërsa për veprën e paragrafit 3 me burg prej tre muaj deri në tre vjet

⁵⁸ Stojanka Mirçeva, Bogdanço Gogov: Analiza e harmonizimit të legjislaturës së Republikës së Maqedonisë me Konventën e Këshillit të Evropës për parandalim dhe luftë kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në shtëpi: (Konventa e Stambollit): studim bazik – Shkup 2013: Lidhja e organizatave të grave të Rpublikës së Maqedonisë

mbushur 14 vjeç. Ligdhënësi ndërmerr masa të veçanta për mbrojtjen e fëmijëve (të moshës nën 14 vjeç) dhe parasheh dënim me burg prej së paku 12 vjet. Më tej, në nenin 188 ndërmerren kriteret e njëjta për sulm seksual ndaj personave të pamundur.

Një grup tjetër i personave i mbrojtur me Kodin Penal janë personat e nënshtruar dhe të varur. Në nenin 189 të Kodit Penal, ku sulmi seksual del prej keqpërdorimit të pozitës, autori do të dënohet me burg prej së paku pesë vjet. Nëse autori është në lidhje gjaku i linjës së parë ose vëlla, gjegjësisht motër, mësimdhënës, edukator, adoptues, tutor ose njerëz dënim i është së paku 10 vjet burg. Përsëri, kriminalizimi bazohet në përdorimin e forcës apo trajtimin e personave të nënshtruar apo të varur në mënyrë e cila e shkel dinjitetin e tyre. Siç u theksua në paragrafin paraprak, vëmendje e veçantë i kushtohet mbrojtjes së personave minorene të cilët zakonisht janë në pozitë të nënshtrimit apo varshmërisë prej mësimdhënësve, kujdestarëve ligjorë apo tutorëve etj.

Sipas nenit 190 të Kodit Penal të Maqedonisë, është i përfshirë dhe i inkriminuar akti i përmbushjes së pasioneve apo nevojave seksuale para një tjetri për të cilën parashihet gjobë në të holla ose dënim me burg deri në një vit. Nëse përmbushja e nevojave apo pasioneve seksuale bëhet para fëmijës ose fëmija detyrohet për një akt të tillë (paragrafi 2 i nenit 190), dënimi me burg është prej tre deri në tetë vjet.

Sipas nenit 191, kryerja e shërbimeve seksuale, si prostitucioni, është gjithashtu vepër penale seksuale për të cilën është paraparë dënim me burg prej pesë deri në dhjetë vjet. Janë paraparë edhe dënime për prostitucionin e organizuar për përfitim, për atë i cili përdor forcë që të detyrohet dikush për prostitucion ose i çon minoret për prostitucion.

Prostitucioni i fëmijëve është rregulluar me vendosjen e nenit të ri 191-a, në pajtim me ndryshimet e KP prej vitit 2014⁵⁹, ndërsa dënimet me burg janë prej katë deri në dhjetë vjet, varësisht veprës.

Sipas nenit 193, shfaqja e materialeve pornografike një fëmije që nuk i ka mbushur 14 vjeç është vepër penale dhe për këtë janë paraparë sanksione përkatëse.

Sipas nenit 194, Kodi Penal e trajton abuzimin seksual të familjarit apo vëllait, motrës si formë e veçantë e deliktit seksual, për të cilën është paraparë dënim me burg prej pesë deri në dhjetë vjet. Nëse, vepra është kryer me person i cili nuk i ka mbushur 14 vjeç, dënimi me burg është minimum 10 vjet.

⁵⁹ Gazeta Zyrtare e RM, numër 27/2014

Sa u takon ligjeve të tjera me të cilat janë rregulluar sulmi seksual dhe përdhunimi, si për shembull Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, kjo formë e veprës penale është përfshirë në përkufizimin për dhunën në familje si një lloj i dhunës së bazuar gjinore.

Ligji për marrëdhënie pune⁶⁰, gjithashtu, fokusohet në mbrojtjen nga shqetësimi dhe shqetësimi seksual në nenin 9⁶¹ dhe parasheh sanksion për personin përgjegjës.

Ligji për shqetësim në vendin e punës (mobing)⁶² i definon obligimet dhe përgjegjësitë e punëdhënësve dhe të punësuarve për mbrojtje nga shqetësimi në vendin e punës. Në këtë ligj, shqetësimi seksual përkufizohet si „çdo akt verbal apo joverbal i cili është me karakter seksual dhe që ka për qëllim ose paraqet shkelje të dinjitetit të punëtorit dhe shkakton ndjenja të pakëndshme, si ndjenjën e frikës apo poshtëërimit.

3.2.2 ANALIZA E HENDEKUT MES LEGJISLACIONIT TË MAQEDONISË SË VERIUT DHE KONVENTËS SË STAMBOLLIT

Si formë e dhunës në bazë gjinore, dhuna seksuale i lëndon dhe i shkel të drejtat njerëzore të grave. Për këtë, shumë konventa ndërkombëtare përqendrohen në instrumentet juridike për luftë kundër dhunës seksuale. Në të njëjtën kohë, legjislacioni kombëtar ka zhvilluar kornizë solide ligjore për mbrojtjen e grave nga çdo lloj sulmi seksual. Megjithatë, duke pasur parasysh seriozitetin e dhunimit si delikt seksual, rëndësi e

.....
⁶⁰ Ligji për marrëdhënie pune, Gazeta zyrtare e RM-së nr. 62/2005 është në dispozicion në <http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/ZRO%20Precisten%2074-15.pdf>

⁶¹ (1) Ndalohet shqetësimi dhe shqetësimi seksual. (2) Shqetësimi dhe shqetësimi seksual paraqet diskriminim në kuptim të nenit 6 të këtij Ligji. (3) Shqetësimi, në kuptimin e këtij Ligji, është çdo sjellje e padëshiruar e shkaktuar prej ndonjërit prej rasteve të nenit 6 të këtij Ligji i cili ka për qëllim të paraqesë shkeljen e dinjitetit të kandidatit për punësim apo punëtorit, ndërsa që shkakton frikë apo krijon sjellje armiqësore, poshtëëruese apo ofenduese. (4) Shqetësimi gjinor, në kuptimin e këtij Ligji, është çdo sjellje verbale, joverbale ose fizike e karakterit seksual që ka për qëllim apo paraqet shkelje të dinjitetit të kandidatit për punësim apo punëtorit, ndërsa që shkakton frikë apo krijon sjellje armiqësore, poshtëëruese apo ofenduese

⁶² Ligji për shqetësim në vendin e punës, Gazeta Zyrtare e RM nr. 79/2013 dhe 147/2015, është në dispozicion në http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/trud_2017/pravilnici/16,,11-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%97%D0%B0%D1%88%D1%82%D0%B8%D1%82%D0%B0%D0%92%D0%BE%D0%B7%D0%A0%D0%B0%D0%B1%D0%9C%D0%B5%D1%81-D1%82%D0%BE.pdf

veçantë i kushtohet mbrojtjes së grave dhe sanksionimit të kryerësve apo autorëve të këtij akti.

Sa i përket veprës së këtillë penale, një hulumtim i fundit tregoi se në BE, çdo e dhjeta femër në moshën 15 vjeçare ka përvojë me ndonjë lloj sulmi seksual, ndërsa çdo e njëzeta grua është dhunuar që nga moshja 15 vjeçare.

Në Maqedoninë e Veriut, dhuna seksuale është një nga format më të shpeshta të dhunës në bazë ligjore, por njëkohësisht edhe një nga më pak të denoncuarat. Shkaqet për nivelin e ulët të denoncimit kanë të bëjnë në mosidentifikimin e deliktit, vlerat patriarkale të shoqërisë ku gratë ende konsiderohen si lëndë seksuale dhe pronë e njeriut, si dhe e veprimeve joprofesionale të zbatuara pasi që të denoncohet vepra. Ministria e Punëve të Brendshme për vitin 2017 ka regjistruar 50 raste të dhunimit⁶³.

Duke i krahasuar dispozitat e Konventës së Stambollit me kornizën ligjore të Maqedonisë së Veriut, me të cilën janë rregulluar sulmi seksual dhe dhunimi, paraqiten disa pyetje për definim dhe interpretim të koncepteve të përdoruara në instrumentet ligjore.

Siç mund të konstatohet nga analiza, në sistemin juridik të Maqedonisë së Veriut, **akti i dhunës seksuale nuk bazohet ndaj konceptit të mungesës së pajtueshmërisë së viktimës, por ndaj konceptit të përdorimit të dhunës**. Domethënë, në raste kur nuk është i pranishëm zbatimi i forcës fizike, është rëndë që të tregohet si vepër penale, si akt i dhunës seksuale. Në të kundërtën, mungesa e pajtueshmërisë jep perceptim më të qartë për atë se a mund të karakterizohet vepra si sulm seksual, të paktën nga ana e viktimës. Në Maqedoninë e Veriut prokuroria dhe organet hetuese ndjekin raste ku viktimat kanë treguar rezistencë për kryerësin e aktit, ku njëkohësisht pa sukses i ndjekin viktimat të cilat nuk kishin mundësi që të kundërshtojnë kryerësin e aktit. Në këtë rast, më së miri është që të vendoset fokusi i pajtueshmërisë së viktimës, të analizohet situata dhe të merren në pyetje dëshmitarët.

Një shembull i mirë për qasje të tillë bazuar në pajtueshmëri gjendet në Kodin Penal të Kanadasë, i cili në nenin 273 paragrafi 1 pajtueshmërinë e definon si “marrëveshje vullnetare e parashtruesit të ankesës për përfshirje në aktivitetin seksual”. Në nenin janë definuar rrethanat dhe situatat në të cilat nuk merret pajtueshmëri:

.....
⁶³ MPB të dhëna për vitin 2017 të disponueshme në internet: <http://www.mvr.gov.mk/analiza/kriminal/55>

- a) *marrëveshja shprehet me fjalët e ndonjë personi tjetër, përveç parashtruesit;*
- b) *parashtruesi nuk është i aftë të japë pajtueshmëri për aktivitetin;*
- c) *i akuzuari e inkurajon parashtruesin që të përfshihet në aktivitet duke e keqpërdorur pozitën e besimit, fuqisë ose autoritetit;*
- d) *parashtruesi nuk pajtohet që të përfshihet në aktivitet me fjalë ose vepra;*
- e) *parashtruesi, i cili është pajtuar që të përfshihet në aktivitetin seksual, shpreh me fjalë ose vepra mungesë të pajtueshmërisë që të vazhdojë të angazhohet në aktivitet.*

Aspekt tjetër me rëndësi në ndjekjen e veprave penale në bazë të sulmit seksual është që të sigurohet se vendimet gjyqësore ose çfarëdo lloj faze tjetër në procesin përfshirë interpretimin e Ligjit të mos jenë nën ndikimin e stereotipave gjinore ose nocioneve ose miteve të kuptuara paraprakisht për seksualitetin femëror ose mashkullor.

Duke i krahasuar dispozitat ligjore të Kodeve Penale të vendeve të rajonit, vetëm ligji kroat e ka vendosur elementin e pajtueshmërisë si kreter për dhunë seksuale. Në sisteme të tjera juridike, ngjashëm si në kornizën juridike maqedonase, vlerësimi për atë se a kualifikohet delikt i caktuar si dhunë seksuale bazohet në përdorimin e dhunës kundër një personi të caktuar.

Vlen të përmendet se në **dispozitat me të cilat rregullohet dhuna seksuale në kornizën juridike maqedonase përdoret fjalor neutral gjinor**. Kjo nënkupton se sulmi seksual mund të kryhet kundër burrave dhe grave. Për shembull: në kodin penal bullgar dispozita nuk është neutrale në bazë gjinore prandaj njeh dhunë seksuale vetëm ndaj grave.

Siç është bërë e ditur në analizë, Koventa jep përshkrim shumë të hollesishëm për pjesë të caktuara të trupit, që është lëshuar në dispozitat e legjislacionit të Maqedonisë së Veriut, Kështu, neni 3 i Konventës **e definon dhunimin si penetrim vaginal, anal ose oral të trupit pa pajtueshmëri të personit tjetër me cilëndo pjesë të trupit ose objekt**. Në nenin 186 të Kodit Penal të Maqedonisë së Veriut nuk është definuar në mënyrë eksplicite se cilat janë elementet e dhunimit. Në vend të kësaj, përdoret termi “dhunim”, që është term i përgjithshëm dhe edhe një fjalë për bërje dashuri, tradhti dhe dhunim, gjegjësisht nuk ka domethënien e dhunës seksuale eksplicite. Për këtë, ligjvënësi duhet të bëjë përpjek-

je shtesë për definim më të mirë të termit “dhunim” dhe ato të jenë në pajtueshmëri me kërkesat e vërtetuara në Konventën e Stambollit në lidhje me elementet e aktit. Gjithashtu, është e rekomandueshme që në procesin e definimit të tij, **të mbulohen të gjitha format e penetrimit jokoncensual, përfshirë pjesë të trupit ose objekte.**

Sa i përket dhunimit në martesë, Kodi Penal e përfshin në definimin për dhunën familjare, por jo edhe në veprën penale dhunim. Edhe raporti i gjashtë periodik i Komitetit për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas në vërejtjet përfunduese shënon: “Definimi për dhunim sipas Kodit Penal (neni 186) nuk përfshin dhunim në martesë dhe kërkon ekzistimin e penetrimit si element i veprës penale”⁶⁴. Prej këtui, komiteti rekomandon që të jepet prioritet në sjelljen e legjislacionit që të përfshihen të gjitha format e dhunës në bazë gjinore, përfshirë edhe dhunën e cila paraqitet te martesat dhe de facto bashkësi, veçanërisht në dhunime në martesë, si në jetën publike dhe private.

Në ridefinimin e kësaj vepre penale duhet pasë parasysh praktika e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, veçanisht vendimi në rastin MC v. Bulgaria, ku gjykata konstaton shkelje të të drejtës për ndalesë nga tortura (neni 3) dhe të drejtën e mbrojtjes së jetës private (neni 8 paragrafi 2) të Konventës nga ana e Bullgarisë. Gjykata ka vërtetuar se “dhunimi është shkelje e integritetit seksual dhe vetëprcaktimi i personit dhe se legjislacioni për dhunim duhet të përqendrohet ndaj dhënies së pajtueshmërisë në vend ndaj përdorimit të forcës si elemente përbërëse të veprës penale dhunim. Përfundimisht, hulumtimi në fokus-grupet tregoi se grumbullimin e të dhënave për dhunim dhe raportimin për këtë veprë penale MPB-ja e bën rregullisht, por pa siguruar **të dhëna të ndara në bazë gjinore për viktimat e dhunimit dhe për kryesit e veprës penale.** Prej këtui nevojitet harmonizim edhe në lidhje me grumbullimin e të dhënave dhe raportimin për dhunimin me nenin 11 të Konventës së Stambollit.

.....
⁶⁴ Raporti i gjashtë periodik i Komitetit për eliminim të të gjitha formave të diskriminimit të grave, Vërejtje përfundimtare, viti 2018 të disponueshme në internet: https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW/C/MKD/CO/6&Lang=En

3.2.3 ANALIZË KRAHASUESE NË LIDHJE ME RREGULLIMIN E VEPRËS PENALE DHUNIM NË LEGJISLACIONET E DISA VENDEVE TË RAJONIT⁶⁵

Konventa e Stambollit (2011) është ratifikuar nga numri më i madh i shteteve të rajonit, por zhvendosja e konceptit të saj në legjislacionet kombëtare është simbolike dhe shpesh është vlerësuar me zbatim të pjesërishtëm. I rëndësishëm për analizë nga aspekti i përfshirjes së veprave penale nga sfera e sulmit seksual dhe dhunimi është Kodi Penal i Kroacisë, i cili është në fuqi nga 4 janari i vitit 2019⁶⁶. Kodi Penal i Kroacisë ka prekur më thellë në zbatimin e KS-së dhe në nenin 152 vendos veprë të re penale. “Marrëdhënie seksuale pa pëlqim” neni 152 (144/12), ndërsa vepra penale “Dhunim” neni 153 është komplementare me veprën paraprake penale. Gjatë kësaj kodi penal i Kroacisë e definon marrëdhënien gjinore pa pëlqim në këtë mënyrë:

1. Kush me person tjetër pa pëlqimin e tij do të kryejë marrëdhënie seksuale ose me të veprim të balancuar seksual, ose thekson person tjetër pa pëlqimin e tij me person të tretë të kryejë marrëdhënie seksuale ose me të veprim seksual, ose pa pëlqimin e tij ndaj vetvetes kryen veprim të barabartë me marrëdhënien seksuale, do të dënohet me burg prej gjashtë muajve deri në pesë vite.
2. Kryerësi i cili ka qenë në hamendje në lidhje me ekzistimin e pëlqimit nga paragrafi 1 i këtij neni, do të dënohet me burg deri në tre vjet.
3. Pëlqim nga paragrafi 1 i këtij neni ekziston nëse personi me vullnetin e tij ka vendosur që të ketë marrëdhënie seksuale ose me të veprim të barabartë seksual dhe ka qenë i aftë që ta sjellë dhe ta shprehë vendimin e tillë. Vlerësohet se pëlqim të tillë nuk ka veçanërisht nëse marrëdhënia seksuale ose me të veprim i barabartë seksual është kryer me përdorimin e kërcënimit, mashtrimit, keqpërdorim të pozitës drejtë personit i cili ndaj kryerësit të aktit është në raport të varësisë, duke e përdorur gjendjen e personit për çka ai nuk ka qenë në gjendje ta shprehë refuzimin e tij

.....
⁶⁵ Kjo pjesë është përgatitur nga ana e prof. Tërpe Stojanovski për nevojat e prezantimit në kuadër të debatit profesional që është mbajtur më 09.04.2019, në Hotel “Aleksander 2” – Shkup.

⁶⁶ <https://www.zakon.hr/z/98/Kazneni-zakon>, (e parë më 05.04.2019) teskt i pastruar: 125/11, 144/12, 56/15, 61/15, 101/17, 118/18 nga 04.01.2019.

ose ndaj personit të cilit në mënyrë të paligjshme i është marrë liria.

Përvoja nga Republika e Kroacisë është e rëndësishme sespe ky është rasti i parë në rajon kur në legjislacion kombëtar penal vendoset elementi i **mungesës së pëlqimit** si kriter për përfshirjen e dhunës seksuale. Në definicion është përfshirë veprimi: **...marrëdhënie seksuale ose me të veprim i barazuar seksual**, me çka ligjvënësi tenton që ta ndjekë frymën e KS-së. Edhe pse nuk i përdor konkretisht shprehjet nga Konventa, megjithatë pranimi i veprimeve "... ose me të veprim seksual i barabartë..." krahas vaginales, mendohet edhe në penetrim vaginal, anal ose oral nga natyra seksuale me cilëndo pjesë të trupit ose objekt në trupin e personit tjetër pa pëlqimin e tij.

Definicioni i veprës penale e inkriminon edhe veprimin e theksimit të personit tjetër pa pëlqimin e tij me person të tretë të kryejë marrëdhënie seksuale ose me të veprim të balancuar seksual ose pa pëlqimin e tij ndaj vetvetes të kryejë veprim të barabartë me marrëdhënie seksuale.

Kështu ligjvënësi në paragrafin 3 definon se kur ekziston Pëlqim nga paragrafi 1 i këtij neni: pëlqim ekziston nëse personi me vullnetin e tij ka vendosur që të kryejë marrëdhënie seksuale ose me të veprim të barabartë seksual dhe ka qenë i aftë që ta sjellë dhe ta shprehë vendimin e tillë. Vlerësohet se pëlqim të tillë nuk ka veçanërisht nëse marrëdhënia seksuale ose me të veprim i barabartë seksual është kryer me përdorim të kërcënimit, mashtrimit, keqpërdorim të pozitës drejtë, keqpërdorim të pozitës drejtë personit i cili ndaj kryerësit të aktit është në raport të varësisë, duke e përdorur gjendjen e personit për çka ai nuk ka qenë në gjendje ta shprehë refuzimin e tij ose ndaj personit të cilit në mënyrë të paligjshme i është marrë liria.

Përfundim: Inkriminimi i sulmit seksual dhe dhunimit në Të drejtën penale kroate është në shumë raste e harmonizuar me KS-në, me çka vetë definicioni rreth qenies së veprës penale përmban precizitet më të madh gjatë vërtetimit të formave të penetrimit jokonsensual (që është kusht për ekzistimin e veprës penale), përfshirë pjesë të trupit ose objekte.

Është me rëndësi që të ndiqet praktika gjyqësore dhe të kontrollohet në jetën reale si funksionon zbatimi i koodit penal, çfarë dilema paraqiten në veprimet, për të cilat tashmë ekzistojnë vendime gjyqësore.

Në linjë të KS-së është edhe praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e ndjekur përmes vendimit në rastin MC v. Bulgaria, ku gjykata konstaton shkelje të të drejtës për ndalesë nga tortura (neni 3) dhe të drejtën e mbrojtjes së jetës private (neni 8 paragrafi 2) të Konventës

nga ana e Bullgarisë. Gjykata ka vërtetuar se “dhunimi është shkelje e integritetit seksual dhe vetëprcaktim i personit” dhe se legjislacioni për dhunim duhet të përqendrohet ndaj dhënies së pajtueshmërisë në vend ndaj përdorimit të forcës si elemente përbërëse të veprës penale dhunim.

3.3 Përndjekja (neni 34)

Në nenin 34 të Konventës së Stambollit përndjekja është definuar si sjellje me paramendim, me kërcënime të vazhdueshme drejtë personit tjetër, duke shkaktuar që ai/ajo të frikësohet për të ose për sigurinë e tij/saj dhe sjellja e tillë duhet të dënohet. Përndjekja mund të manifestohet në forma të ndryshme, siç janë ndjekja e vazhdueshme e viktimës, realizimi i komunikimit të padëshiruar, paraqitja në vende ku punon, jeton ose e viziton rregullisht një person etj. Gjithashtu, viktimat mund të ndiqet dhe shqetësohet përmes rrjeteve sociale.

Maqedonia e Veriut me nenin 4 paragrafi 7 të Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna familjare e definojnë përndjekjen si sjellje me paramendim, me kërcënime të vazhdueshme drejt personit tjetër, duke shkaktuar që ai/ajo të frikësohet për të ose për sigurinë e tij/saj dhe sjellja e tillë duhet të dënohet⁶⁷. Shihet qartë se definicioni është marrë nga Konventa e Stambollit. Megjithatë, duke pasur parasysh nenin 78 paragrafi 4, kur Konventa iu jep mundësi vendeve të cilat ratifikojnë ta ruajnë të drejtën, të vendosin masa jopenale, siç janë ndalesa për afrim dhe kufizim të lëvizjes së kryerësit. Në këto raste, masa adekuate do të ishin ato të cilat përfshijnë ndalesë për maltretim të viktimës, ndalesë për çfarëdo lloj kontakti me viktimën ose me ndonjë anëtar të familjes së tij, ndalesë për thirrje telefonike deri te viktimat dhe afrim deri te viktimat në distancë prej së paku 100 metra afër shkollës, vendit të punës ose vendbanimit. Ligji për parandalimin e dhunës familjare në nenet 34-36 rregullon masa të tilla. Ligji parashihet afat prej 24 orëve për masa mbrojtëse kohore (sipas nenit 34 dhe 35) me propozim të policisë. Janë përcaktur edhe masa për ndalimin e afimit dhe ndalim për kontakt me personin viktimë në periudhë ndërmjet 10 dhe 30 ditëve. Por, të dhënat për periudhën nga janari i vitit 2015 deri në korrik të vitit 2016 prej gjithsej 4.398 raste të dhunës familjare të regjistruara nga MPB-ja, vetëm në 401 raste ishte inicuar masë mbrojtëse kohore, prej të cilave nga gjykata ishin pranuar 87 %

.....
⁶⁷ Kjo dispozitë hyri në fuqi 01.01.2015

nga masat e propozuara, 3 % ishin refuzuar, 2 % ishin liruar, përderisa 8% ishin tërhequr propozimet⁶⁸.

Shteti duhet të sigurojë mbrojtje të viktimave edhe nga shtete të tjera kur ato janë në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut sipas Direktivës DIRECTIVE 2011/99/EU për Urdhrin evropian për mbrojtje. Sipas kësaj direktive, vendet anëtare të cilat mbrojtja e viktimave realizohet përmes masave për mbrojtje të sjellura nga gjykata me propozim të policisë, duhet ta pranojnë si të vlefshme urdhrin për mbrojtje të dhënë nga ndonjë vend tjetër anëtar i BE-së dhe të sigurojë mbrojtje në pajtim me të drejtën vendore⁶⁹. Duke pasur parasysh aspiratën që të bëhet vend anëtar i BE-së, Maqedonia e Veriut duhet të parashohë edhe pranimin e urdhrit evropian për mbrojtje.

Megjithatë, vendimi i tillë që të definohet përndjekja si vepër penale dhe të sillen masa jopenale është ndryshe nga veprimi i të gjitha vendeve të tjera nga rajoni. Për shembull, Bosnjë e Hercegovina në vitin 2015 e ndryshoi Kodin Penal dhe e kriminalizoi përndjekjen, si edhe Mali i Zi dhe Serbia⁷⁰ me kodin penal i cili hyri në fuqi nga 01.06.2017. Kroacia, gjithashtu, bëri ndryshime të paragrafit 142 të Kodit Penal, me përjashtim të Bullgarisë, ku asnjë dispozitë nuk e rregullon përndjekjen si vepër penale.

Prej këtu mund të përfundohet se korniza juridike e Maqedonisë së Veriut, përndjekjen kryesisht e trajton përmes prizmit të dhunës vendore dhe familjare, me qëllim që të sigurojë mbrojtje për viktimat dhe të parandalohet dhuna e mëtutjeshme drejtë tyre. Megjithatë, për shkak të seriozitetit të kësaj forme të dhunës në bazë gjinore, duke e pasur parasysh se shkakton frikë dhe shqetësim të viktimat, Kodi Penal është i obliguar ta zgjidhë këtë çështje dhe ta dënojë këtë akt. Sipas një studimi të zbatuar në Bashkimin Evropian, përndjekja në mënyrë joproporionale ndikon më shumë ndaj grave se sa ndaj burrave, që nënkupton se në pjesën më të madhe viktimat janë gra, ndërsa kryerësit e aktit burra. Edhe krahas kësaj, studimi megjithatë tregoi se gjysma e vendeve ende nuk kanë vendosur dispozita për rregullimin e kësaj çështje.

⁶⁸ Zorica Saltirovska, Sunçica Dimitrioska (2017), "Legal and Institutional Functionality in the Protection of Women – Victims of Domestic Violence in the Republic of Macedonia – Present Situation and Future Perspectives", European Journal of Social Sciences Education and Research, Vol.10 Nr. 2, p.137

⁶⁹ DIRECTIVE 2011/99/EU për Urdhrin evropian për mbrojtje në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:32011L0099&from=EN>

⁷⁰ Council of Europe, <https://rm.coe.int/grevioinf-2018-9/16808c1a4e>

Në Maqedoninë e Veriut, një hulumtim nga viti 2012 i Reaktor, hulumtim në aksion në të cilin shqyrtohet shkalla dhe dimensionet e ndryshme të dhunës ndaj grave në hapësirën publike, duke u përqendruar fillimisht në perceptimet e grave për sigurinë e tyre dhe ndikimin të cilin e ka ndaj jetës së tyre, si dhe forcat e dhunës të cilat ato i përjetojnë në vende publike, tregon se një përqindje e madhe prej 61,3 % e grave vështrohen në vende publike, 53,9% e grave përjetojnë thirrjen me etiketime dhe emra stereotipë, 46,9% pranojnë komente seksiste për dukjen e tyre përderisa 33,3 përndiqen⁷¹. Sipas kësaj, është e nevojshme që të ndërmerren hapa të mëtutjeshëm që të sigurohet se përndjekja do të trajtohet si formë e dhunës në bazë gjinore. Rregullimi i elementeve nga përndjekja me nenin 144 të Kodit Penal të RM-së⁷² nuk mjafton. Rrezikimi i sigurisë si vepër penale në paragrafin 1 i inkriminon veprimet e rrezikimit të sigurisë së dikujt tjetër me kërcënim serioz se do të sulmojë ndaj jetës ose trupit të tij ose jetës dhe trupin e ndonjë të afërmi të tij, ndërsa në paragrafin 2 dënohet ai i cili do ta kryejë veprën nga paragrafi 1 gjatë kryerjes së dhunës familjare. Megjithatë, vepra e definuar kështu nuk e njeh dimensionin gjinor e as gjenezën e veprës penale del nga stereotipat gjinore dhe pabarëzia gjinore ndrmjet burrave dhe grave. Gjithashtu, dispozita nga neni 144 ka të bëjë me integritetin trupor, përderisa dispozita e Konventës së Stambollit ka të bëjë me gjendjen psikologjike të frikës. Për këtë shkak duhet që ose Kodi Penal ta rregullojë këtë vepër penale që të jetë përgjegjëse në bazë gjinore ose ta inkriminojë përndjekjen si vepër e re penale me dispozita përmes së cilave do të parashihen edhe sanksione për kryerësit, ndërsa njëkohësisht do të sigurohet mbrojtje për viktimat.

3.4 Shqetësimi seksual (neni 40)

Shqetësimi seksual është rregulluar me nenin 40 të Konventës së Stambollit, në të cilën vendet thirren “që t’i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme ligjvënëse ose masa të tjera për kriminalizimin e çfarëdo lloji forme të sulmit verbal, joverbal ose fizik nga natyra seksuale me qëllim të shkeljes së dinjitetit të ndonjë personi, veçanërisht gjatë krijimit të rrethinës frikësuese, degraduese, poshtëruese ose ofenduese”.

⁷¹ Reaktor hulumtimi në aksion, (2012), Hulumtim për shkallën e dhunës me bazë gjinore në vende publike në qytetin e Shkupit

⁷² Vepra penale “Rrezikim i sigurisë”

Defnimi i shqetësimit seksual i paraparë në nenin 1, paragrafi 2⁷³ i Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi⁷⁴. Sipas dispozitave ligjore, secili person i cili vlerëson se ndaj tij është bërë diskriminim mund të parashetrojë ankimim deri te Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi, i cili vepron në pajtim me kompetencat e tij ligjore. Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi përmban dispozita kundërvajtëse për shkeljen e dispozitave të Ligjit dhe parasheh gjobë në vlerë prej 400 deri 600 euro në kundërvlerë denari. Krahas gjobës së paraparë për thirrje, inkurajim dhe ndihmë e veprimeve diskriminuese për persona fizikë dhe juridikë, veçanërisht parashihet gjobë për shkeljen e dispozitave nga neni 7 (shqetësim seksual)⁷⁵.

Shqetësimi seksual në vendin e punës gjithashtu vlerësohet si formë e diskriminimit, prandaj shumë sisteme kombëtare juridike e rregullojnë në kuadër të të drejtës qytetare ose të punës. Për këtë, Konventa e Stambollit lejon diskrecion në menaxhimin me shqetësimin seksual përmes të drejtës kombëtare penale, të drejtës administrative ose sanksione të tjera juridike.

Duke e pasur parasysh faktin se shqetësimi seksual mund të paraqitet në shumë vende, siç janë shkollat, vendet e punës, spitalet, hapësirat publike, etj, nevojiten instrumente ligjore të cilat e tejkalojnë Ligjin për marrëdhënie pune. Kjo është një nga shkaqet pse shumë trupa ndërkombëtarë i rekomandojnë edhe instrumentet penale dhe jopenale me qëllim që të sigurojnë mbrojtje të viktimave potenciale me sanksione adekuate ligjore.

.....
⁷³ (1) Shqetësimi dhe veprimi poshtërues paraqet shkelje të dinjitetit të personit apo një grupi personash që del prej bazës diskriminuese dhe që ka për qëllim apo rezultat degradimin e dinjitetit të një personi të caktuar apo krijimin e mjedisit kërcënues, armiqësor, poshtërues apo frikësues, qasje apo praktikë. (2) Shqetësimi seksual është sjellje e padëshiruar me karakter seksual, që shprehet fizikisht, në mënyrë verbale ose no çfarëdo mënyre tjetër, ndërsa ka për qëllim apo pasojë degradimin e dinjitetit të një personi, veçanërisht kur krijohet mjedis armiqësor, kanosës, degradues apo poshtërues

⁷⁴ Ligji për mbrojtje nga diskriminimi, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.50/2010, në dispozicion në http://mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/diskriminacija_konsolidiran.pdf

⁷⁵ Stojanka Mirçeva, Bogdanço Gogov: Analiza e harmonizimit të legjislaturës së Republikës së Maqedonisë me Konventën e Këshillit të Evropës për parandalim dhe luftë kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në shtëpi (familje): (Konventa e Stambollit): studim bazik – Shkup 2013: Lidhja e organizatave të grave të Rpublikës së Maqedonisë

Shqetësimi seksual është definuar dhe rregulluar me Ligjin për mbrojtje nga shqetësimi në vendin e punës (mobing)⁷⁶ i cili hyri në fuqi më 31.5.2013. Siç është theksuar në nenin 2 të Ligjit, qëllimi është që të parandalohet dhe mbrohet secili person nga shqetësimi psikik dhe seksual në vendin e punës dhe të sigurohet mjedis i shëndoshë i punës.

Neni 4 më tutje thekson se me këtë Ligj ndalohen të gjitha llojet e shqetësimeve në vendin e punës. Pastaj, neni 5 paragrafi 2 e definon shqetësimin seksual si secilin sulm verbal, joverbal ose fizik ndaj natyrës seksuale me qëllim të degradimit të dinjitetit të punëtorit, që krijon ndjenjën e frikësimit, armiqësisë, poshtërimit.

Më tutje, Ligji në paragrafët e më tutjeshëm i definon kryerësit apo autorët e veprës penale, në vendin e punës dhe jep sqarim të hollësishëm për atë që konsiderohet si shqetësim psikologjik ose seksual. Në Kapitullin III, Ligji i përcakton të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve, përderisa kapitulli IV jep përshkrim për veprimet dhe mbrojtjen te punëdhënësit.

Sa i përket sanksioneve për shkeljen e të drejtave të të punësuarve në lidhje me shqetësimin seksual, Ligji parasheh dënime financiare për autorët të cilat mund të variojnë prej 1.000 deri në 6.000 euro.

Shqetësimi seksual është definuar dhe rregulluar me Ligjin për mbrojtjen nga shqetësimi në vendin e punës, së bashku me torturën psikike (mobing). Megjithatë, më shumë bazohet në diskriminim sesa në formë të dhunës në bazë ligjore. Në këtë pikëpamje, shqetësimi seksual nuk është kriminalizuar, kështu që kjo nuk është në pajtim me Konventën e Stambollit. Deri më tani sanksionet përfshijnë gjopa financiare në të holla për autorët dhe punëdhënësit nëse nuk arrijnë t'i ndalojnë ose t'i mbrojnë të punësuarit nga zbatuesit. Megjithatë, legjislacioni penal për shqetësimin seksual nuk duhet t'i heqë sanksionet ekzistuese, por t'i plotësojë.

Shembull i mirë për vendosjen e shqetësimit seksual në Kodin Penal është Franca, ku në nenet 222, 223 ai akt definohet si imponim i përhershëm me fjalë ose veprime të cilat janë në konotacion seksual ose ndikojnë në dinjitetin e personalitetit drejtë të cilit janë drejtu-

.....
⁷⁶ Ligji për shqetësim në vendin e punës, Gazeta zyrtare e RM-së nr. 79/2013 dhe 147/2015 në dispozicion në http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/trud_2017/pravilnici/16,,11-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%97%D0%B0%D1%88%D1%82%D0%B8%D1%82%D0%B0%D0%92%D0%BE%D0%B7%D0%A0%D0%B0%D0%B1%D0%9C%D0%B5%D1%81%D1%82%D0%BE.pdf

ar nga natyra degraduese dhe poshtëruese ose e vendosin në situatë frikësuese, armiqësore.

Maqedonia e Veriut duhet **ta vendosë shqetësimin seksual si veprë penale në Kodin Penal dhe të definojë sanksione adekuate për autorët e tij**. Përgjegjësia dënuese për shqetësimin seksual duhet të marrë cilësi të re me definimin e dhunës ndaj grave⁷⁷.

3.5 Martesat e dhunshme (neni 37)

Neni 37 i Konventës së Stambollit kërkon që të kriminalizohen martesat e dhunshme që përfshijnë: a) detyrimin e personit të moshës madhore ose fëmijës të lidhë martesë dhe b) ta detyrojë personin e moshës madhore ose fëmijën në territorin ose ndonjë shteti tjetër nga ai ku jeton të lidhë martesë. Në Raportin për sqarimin e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave, paragrafet 195, 196 dhe 197 theksohet se kriminalizimi i këtyre veprave do të vlerësohet në bazë të pëlqimit të viktimës, gjegjësisht viktimja duhet padyshim dhe në mënyrë eksplicite të pajtohet me martesën pa kurrfarë presioni fizik, psikologjik ose forme tjetër të forcës. Që nënkupton, se pëlqimi është element i rëndësishëm i dy veprave: dhunim dhe martesë e dhunshme. Vepër penale gjithashtu është “mashtrimi” i personit në vende të huaja me qëllim të lidhjes së martesës, pa u marrë parasysh se si është bërë martesa, dhe a është bërë me të vërtetë.

Kërkesat nga Konventa e Stambollit përqendrohen në martesën e hershme/fëmijërore dhe vendosin lidhje ndërmjet të dytës dhe martesave të dhunshme, si dhe kriminalizimin e veprave të tilla. Për qëllimet e Konventës dhe sipas Konventës së KB-së për të drejtat e fëmijës, fëmijë konsiderohen personat e moshës nën 18 vjeç.

Krahas kësaj, shteti duhet të sigurojë masa adekuate në pajtim me ligjin me të cilin rregullohen martesat, siç janë: regjistra për martesa, divorc, kujdes ndaj fëmijëve dhe çështje imuniteti. Sipas nenit 33 të Konventës, viktimave duhet t’iu mundësohet që t’i ndërprejnë martesat e dhunshme pa kurrfarë bare financiare dhe administrative.

Martesat e fëmijëve në Maqedoninë e Veriut nuk janë rregulluar në mënyrë autonome me Kodin Penal. Një aspekt i veprës penale që është

⁷⁷ Tërpe Stojanovski dhe Iskra Andreeva, *Vlerësimi për ndikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndaj legjislaturës vendore*, dokument i brendshëm

kriminalizuar me nenin 37 të Konventës së Stambollit është që martesat e dhunshme janë si pjesë e tregtisë me njerëz dhe tregtisë me fëmijë, si dhe pasojat nga martesat nga ai delikt. Këto vepra janë kriminalizuar me nenin 418-a⁷⁸, ndërsa Ligji parasheh burg së paku prej 4 viteve për autorët, ndërsa për autorët në tregtinë me fëmijë së paku 8 vite. Edhe pse thelbi i veprës është rregulluar, megjithatë vëllimi i tij i kufizuar vetëm në rast të tregtisë me njerëz dhe tregti me fëmijë e bën harmonizimin me Konventën e Stambollit të pjesërishme. Njëkohësisht, neni 6⁷⁹ i Kodit Penal pjesërisht e inkriminon martesën e minorenëve me atë që mundëson zbatim të Konventës edhe ndaj personave minorenë. Megjithatë, ajo që KP nuk e mundëson është që ta inkriminojë mashtrimin e qëllimshëm të personit të rritur ose fëmisë në territorin e vendit ose në ndonjë vend tjetër me qëllim që të detyrohen personat e moshës madhore ose fëmijët që të lidhin martesë.

Për këtë martesat e dhunshme dhe martesat me fëmijë në Maqedoninë e Veriut duhet të rregullohen me dispozita të veçanta të Kodit Penal, siç kërkohet nga Konventa e Stambollit dhe neni 37 i saj. Edhe Plani aksional për zbatimin e Konventës së Stambollit e parasheh këtë. Për këtë qëllim ekzistojnë qasje të ndryshme në botë për atë se si të menaxhohet me këtë çështje. Praktika e mirë që mund të ndiqet është Kodi Penal norvegjez⁸⁰, i cili e definon veprën penale të martesave të dhunshme si “Secili person i cili me dhunë, privim nga liria, presion joad-ekuat ose sjellje tjetër joligjore ose me kërcënime nga sjellja e tillë e

.....
⁷⁸ (1) Ai i cili me dhunë, kërcënim serioz sjellë deri te mashtrimi apo forma tjera të detyrimit, rrëmbimit, mashtrimit, me keqpërdorim të pozitës së tij apo në gjendje të shtatëzanisë, pafuqisë fizike dhe paaftësisë mentale të tjetrit, ose me dhënie dhe pranimin e parave ose përfitimi tjetër për shkak të marrjes së pajtueshmërisë së personit i cili ka kontroll ndaj personit tjetër ose në mënyrë tjetër rekruton, transporton, mbart, blen, shet, fsheh ose pranon persona për shkak të eksploatimit në rrugë për prostitucion ose forma të tjera të eksploatimit seksual, pornografisë, punës së detyruar ose robërimit, skllavërimit, martesës së dhunshme, fertilizimit të dhunshëm, përvetësimit të jashtëligjshëm dhe apo marrëdhënies së ngjashme apo transplantimit të papranueshëm të pjesëve trupore të njeriut, do të dënohet me burg më së paku 5 vjet. (5) Pajtueshmëria e viktimës për trafikimin e njerëzve për shkak të qëllimit për eksploatim të paraparë në paragrafin 1 jo nga rëndësia e ekzistimit të veprës penale nga paragrafi 1.

⁷⁹ Neni 6-a (1) Kodi Penal nuk zbatohet ndaj fëmijës i cili në kohën kur e ka kryer veprën e cila parashihet me Ligj si vepër penale nuk ka mbushur katërmëdhjetë vjet. (2) Ndaj të miturve dhe personave të pjekur më të ri në moshë për vepra penale të parapara me Ligj ose marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut zbatohen dispozitat e këtij ligji, nëse me Ligj nuk është parashikuar ndryshe.

⁸⁰ Kodi penal i Norvegjisë, në dispozicion në https://lovdata.no/dokument/NLE/lov/2005-05-20-28/*#*

detyron secilin që të lidhë martesë, do të jetë fajtor për shkaktikimin e martesës së dhunshme”⁸¹.

Opsion tjetër për menaxhim me martesë të dhunshme është që të kriminalizohet secila vepër në të cilën zbatohet forcë ose përdoren kërcënime të cilat do të shkaktojnë frikë dhe vuajtje te ndonjë person tjetër, ndërsa efektuohen me lidhjen e martesës. Gjithashtu, ndalesë e plotë e martesës së personave minorenë ose me persona minorenë. Ky është rast me të drejtën penale gjermane, e cila e trajton martesën e dhunshme si vepër serioze penale.

3.6 Gjymtimi i gjenitaleve femërore (neni 38)

Gjymtimi i gjenitaleve femërore është kriminalizuar sipas nenit 38 të Konventës së Stambollit. Konventa thotë se vendet duhet t’i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme legislative ose masa të tjera që të mbrojnë dhe parandalojnë që secili person të presë, të tredhë ose të kryejë çfarëdo lloj gjymtimi të gjithë vaginës ose të ndonjë pjese të vogël ose të madhe të buzëve vaginale ose klitorisit. Më tutje, si element tjetër përbërës i veprës penale do të shqyrtohet veprimi i detyrimit të gruas që t’i nështrohet ndonjë veprimi të theksuar në paragrafin e parë. Elementi i ardhshëm i veprës penale vlerësohet inkurajimi ose detyrimi i vajzës që t’i nënshtrohet ndonjë veprimi të theksuar në paragrafin (a).

Megjithatë duhet të theksohet se edhe pse këto vepra penale tashmë janë kriminalizuar si krime kundër personave si lëndim trupor ose torturë, duke e pasur parasysh natyrën e dhunshme, invazive ose të dhimbshme të vepërve penale me përfshirjen e tyre në Konventën e Stambollit, qëllimi është që të mbulohet aspekti i dhunës në bazë gjinore, gjegjësisht se dhuna bëhet për shkak të marrëdhënieve jo të barabarta mes burrave dhe grave. Viktimave u jepen masa ligjore për luftë kundër detyrimit, të cilat mund të zbatohen edhe kundër detyrimit nga prindërit, gjyshet ose gjyshërit ose të afërm të tjerë të cilët i detyrojnë vajzat e tyre ose të afërmet e tyre që t’i nështrohen veprimit.

Ndëshkimi i gjymtimit të gjenitaleve femërore nuk është rregulluar me Kodin Penal të Maqedonisë së Veriut, siç është paraparë me nenin 38 të Konventës së Stambollit. Një aspekt që është përfshirë me Kodin Penal

.....
⁸¹ Seksioni 253 nga Kodi Penal i Norvegjisë i disponueshëm në https://lovdata.no/dokument/NLE/lov/2005-05-20-28/*#*

janë dispozitat nga nenet 130⁸² dhe 131⁸³, të cilët i dënojnë lëndimin fizik dhe lëndimin e rëndë fizik. Siç mund të shihet në Kodin Penal, në asnjë paragraf të të dy neneve të cilat e rregullojnë lëndimin fizik në mënyrë eksplicite nuk është përmendur asnjë pjesë e trupit të femrës që mund t'i japë dimension në bazë gjinore veprës penale. Megjithatë, duke e pasur parasysh seriozitetin e aktit, i cili mund të ketë dëmtim potencial shëndetësor të jetëve të grave dhe vajzave, duhet të definohet në mënyrë eksplicite si vepër penale. Gjymtimi i gjenitaleve femërore është pjesë e procedurës tradicionale të synetimit të femrave në disa pjesë të botës. Edhe pse në vend nuk kultivohen tradita të tilla duke e pasur parasysh globalizimin dhe emigrimet (lëvizjen e njerëzve), procedurë e tillë mund të bëhet edhe në territorin e vendit. Për këtë nevojitet që të kriminalizohet vepra në territorin e të gjitha vendeve nënshkruese që të kontribuohet për çrrënjosjen e praktikës së tillë. Përveç kësaj, Maqedonia e Veriut duhet të sjellë masa për mbulimin e rrethanave specifike rënduese të kësaj sjellje, të cilat do të mund të përdroreshin për ndjekjen efikase të veprës penale dhunë fizike, si dhe kriminalizimin e aspektit të detyrimit të përcaktuar me paragrafin c të nenit 38.

.....
⁸² (1) Ai i cili dikë tjetër do ta lëndojë fizikisht ose do t'i dëmtojë shëndetin, do të dënohet me gjobë në të holla ose me burg deri në tre vite. (2) Ai i cili do ta kryejë veprën nga paragrafi 1 gjatë kryerjes së dhunës familjare, do të dënohet me burg prej gjashtë muaj deri në tri vite. (3) gjykata mundet kryesisht të veprës nga paragrafi 1 t'i shqiptojë vërejte gjyqësore nëse është shkaktuar me sjellje veçanërisht ofenduese ose brutale ndaj të dëmtuarit (4) ndjekja për veprën nga paragrafi 1 ndërmerret sipas padisë private, ndërsa për paragrafin 2 me propozim.

⁸³ (1) Ai i cili dikë tjetër do ta lëndojë fizikisht ose do t'i dëmtojë shëndetin rëndë, do të dënohet me burg prej gjashtë muaj deri në pesë vite. (2) Ai i cili do ta kryejë veprën nga paragrafi 1 gjatë kryerjes së dhunës familjare, do të dënohet me burg prej një deri në pesë vite (3) Ai i cili dikë tjetër do ta dëmtojë fizikisht ose do t'i dëmtojë shëndetin rëndë dhe për këtë do të vendoset në rrezik jeta e të dëmtuarit ose do t'i shkatërrohet ose do t'i dobësohet në masë të madhe ndonjë pjesë e rëndësishme e trupit ose ndonjë organ i rëndësishëm ose do të shkaktohet paaftësi e përhershme për punë në përgjithësi ose për punën për të cilën është i aftësuar ose rëndë dhe në mënyrë të përhershme do t'i dëmtohet shëndeti i tij ose do të shëmtohet, do të dënohet me burg prej një deri në dhjetë vite. (4) Nëse për shkak të lëndimit të rëndë fizik nga paragrafët 1 deri 3 i lënduari ndërron jetë, kryesi i veprës do të dënohet me burg më së paku një vit. (5) Ai i cili kryen nga paragrafët 1 dhe 2 do ta kryejë nga pakujdesia, do të dënohet me dënim në të holla ose me burg deri në tri vite. (6) Ai i cili kryen do ta kryejë për një çast, pa fajin e tij në gjendje të acarimit të fortë me sulm ose me ofendim të rëndë ose si pasojë e dhunës familjare nga ana e të lënduarit, do të dënohet për veprën nga paragrafët 1 dhe 2 me gjobë në të holla ose me burg deri në tre vite, ndërsa për veprën nga paragrafët 3 dhe 4 me burg nga një deri në pesë vite.

3.7 *Arsyetim i papranueshëm i krimeve, përfshirë edhe krimet e kryera në emër të të ashtuquajturit “nder” (neni 42)*

Neni 42 i Konventës së Stambollit i detyron shtetet që t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që të sigurojnë se kultura, tradita, religjioni, adetet ose i ashtuquajturi “nder” nuk vlerësohen si arsyetim për ndonjë akt të dhunës të përfshirë në Konventë. Kjo nënkupton se nga palët kërkohet që të sigurojnë se e drejta penale dhe e drejta penalo-procesuese nuk lejojnë që i akuzuari t'i arsyetojë veprat e tij si të kryera me qëllim që të ruajë norma ose tradita kulturore, fetare, sociale ose tradicionale. Në kuadër të nenit 42, gjithashtu, rregullohet se nuk arsyetohen krimet (vrasje, dhunim, etj) të cilat janë bërë me humbjen e vetëkontrollit (për shkak të xhelozisë, keqpërdorim të substancave ose drogave). Në lidhje me këtë, vendet anëtare, gjithashtu, duhet t'i parandalojnë këto elemente që të krijojnë rrethana lehtësuese konkrete të cilat do të sjellin deri te ulja e sanksioneve. Sipas dispozitave të Kodit Penal të Maqedonisë së Veriut kultura, doket, traditat ose nderi nuk sigurojnë bazë të fortë për arsyetimin e krimeve. Në disa raste, këto rrethana lehtësuese mund të merren parasysh vetëm në rastet kur vepra penale ka ndikim të parëndësishëm ndaj humbjes materiale ose financiare ose shkalla e veprës penale është përqindje shumë e vogël dhe sanksionet janë më të vogla se 3 vite burg. Megjithatë, marrë në përgjithësi, Kodi Penal i Maqedonisë së Veriut nuk përfshin arsyetim në bazë të të ashtuquajturit nder, vlere fetare.

Në paragrafin e dytë, neni 42 i rregullon krimet e kryera nga një fëmijë për nder të emrit. Kështu, dispozita ashpër ndalon arsyetimin e veprave penale në situatë kur kryesi është i moshës nën përgjegjësi penale, kur këtë e inkurajon person tjetër ose anëtar i familjes që ta kryejë veprën penale. Neni 6 i Kodit Penal i liron personat minorenë nga përgjegjësia, por paragrafi i dytë i nenit⁸⁴ mundëson zbatimin e Konventës edhe ndaj personave minorenë. Përveqë kësaj, Maqedonia e Veriut duhet të

⁸⁴ Neni 6-a (1) Kodi Penal nuk zbatohet ndaj fëmijës i cili në kohën kur e ka kryer veprën e cila parashihet me Ligj si vepër penale nuk ka mbushur katërmëdhjetë vjet. (2) Ndaj të miturve dhe personave të pjekur më të ri në moshë për vepra penale të parapara me Ligj ose marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut zbatohen dispozitat e këtij ligji, nëse me Ligj nuk është parashikuar.

vendosë masa për mbulimin e rrethanave specifike rënduese të kësaj sjelljeje, të cilat do të mund të përdoren për ndjekjen efikase të veprës penale dhunë fizike.

Rrethanat e rënduara dhe vjetërsia

Konventa në nenin 46 kërkon që të parashihen **rrethana rënduese** gjatë përcaktimit të dënimit për këto vepra. Kështu këto rrethana duhet të jenë pjesë e veprave penale ose të parashihen në pjesë tjetër të legjislacionit:

- ✓ vepra ishte kryer ndaj ish ose bashkëshortëve të tanishëm ose partner i pranuar nga e drejta në vend, nga anëtar i familjes, person i cili jeton me viktimën ose person i cili e ka keqpërdorur autoritetin e tij;
- ✓ vepra ose veprat e ngjashme ishin përsëritur;
- ✓ vepra ishte kryer ndaj individit i cili ishte i ndjeshëm për shkak të rrethanave konkrete;
- ✓ vepra ishte kryer ndaj ose në prani të fëmijës;
- ✓ vepra ishte kryer nga dy ose më shumë njerëz të cilat kanë vepruar bashkë;
- ✓ veprës i ka paraprirë ose ishte e shoqëruar me nivel ekstrem të dhunës;
- ✓ vepra ishte kryer me përdorim ose kërcënim me armë;
- ✓ vepra ka rezultuar me dëm të rëndë fizik ose psikik për viktimën;
- ✓ kryesi paraprakisht ka qenë i gjykuar për vepra të natyrës së ngjashme

Nenin 39 i Kodit Penal përmban rregulla të përgjithshme për përcaktimin e dënimit. Ligji nuk i diferencon rrethanat lehtësuese nga ato rënduese, por gjykatës ia lë këtë vlerësim. Dispozita e përgjithshme për përcaktimin e dënimit nga paragrafi 2⁸⁵ i këtij neni e obligon gjykatën që t'i ketë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë që dënimi të jetë më i vogël ose më i madh (rrethana lehtësuese dhe rënduese).

.....
⁸⁵ shkalla e përgjegjësisë penale, motivet nga të cilat është kryer vepra, fuqia e rrezikut ose lëndimi i së mirës mbrojtëse, rrethanat nën të cilat është kryer vepra, kontributi i viktimës në kryerjen e veprës, jeta e paraprake e kryesit, mundësisë e tij personale dhe sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale, si dhe rrethanat të cilat kanë të bëjnë me personalitetin e kryesit.

Gjithashtu, gjatë përcaktimit të dënimit, ndikim ka: a është vepra paraprake e llojit të njëjtë si vepra e re, a janë kryer veprat për motive të njëjta dhe sa kohë ka kaluar që nga gjykimi paraprak, gjegjësisht nga vuajtja ose falja e dënimit, a është kryer vepra penale kundër një personi ose grupi të personave ose pronë, direkt ose indirekt, për shkak të origjinës së tij ose tyre kombëtare dhe sociale, bindjes politike dhe fetare, pozitës pronësore dhe shoqërore, gjinisë, racës ose ngjyrës së lëkurës; gjendjes pronësore të kryesit, duke mbajtur llogari për të ardhurat e tjera të tij, për pronën e tij dhe për obligimet familjare.

Edhe krahas asaj që këto dispozita në mënyrë implicite korrespondojnë me ato të Konventës, megjithatë nevojitet që të shqyrtohet mundësia për futjen e plotë të tyre dhe harmonizimin e legjislacionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut me Konventën⁸⁶.

Neni 58⁸⁷ i Konventës së Stambollit rregullon detyrimin e vendeve nënshkruese që të përcaktojnë mjaftueshëm gjatë dhe proporcionalisht peshën e veprës penale periudhën e vjetërsisë së veprës. Legjislacioni penal në Maqedoninë e Veriut njeh **vjetërsim të ndjekjes** dhe **vjetërsim të vuajtjes** së sanksionit penal. Afatet për vjetërsim, rrjedha dhe ndërprerja e vjetërsisë dhe mosvjetërsia janë të rregulluara me nenet 107, 108 dhe 112 të KP.

Vjetërsia absolute për ndjekjen e të gjitha veprave penale për të cilat është lejuar vjetërsi ekziston pasi do të kalojë “dyfish më shumë kohë se sa që sipas ligjit kërkohet për vjetërsim të veprës penale” (neni 107, paragrafi 6 i KP). “Afatet e vjetërsisë nuk garantojnë pasi të kalojnë 18 vite, fëmijët të cilët kanë qenë viktimë të dhunës seksuale për secilën nga veprat penale të ngrisin procedurë ndjekje”⁸⁸. Në mënyrë plotësuese në nenin 112 të KP është paraparë mundësia për mosvejtërsim të ndjekjes penale, nëse kjo është paraparë me marrëveshje ndërkombëtare e cila është ratifikuar.

.....
⁸⁶ Tërpe Stojanovski dhe Iskra Andreeva, *Vlerësimi për ndikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndaj legjislaturës vendore*, dokument i brendshëm

⁸⁷ Palët i ndërmarrin legjislacionet e nevojshme dhe masat e tjera që të sigurojë se vjetërsia për ngritje të cilësdo procedurë juridike në lidhje me veprat penale të verifikuara me nenet 36, 37, 38 dhe 39 nga kjo Konventë të zgjasë mjaftë gjatë dhe proporcionalisht me peshën e veprës penale e cila është në pyetje që të mundësojë nisje/ ngritje efikase të procedurës pasi viktimë të jetë i pjekur.

⁸⁸ Stojanka Mirçeva, Bogdanço Gogov: *Analizë e përputhshmërisë së legjislacionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut me Konventën e Këshillit të Evropës për parandalim dhe luftë kundër dhunës ndaj gruas dhe dhunës familjare*: (Konventa e Stambollit): Studim bazik – Shkup 2013: Lidhja e organizatave të grave e Republikës së Maqedonisë.

Masa të përkohshme për mbrojtjen e viktimave nga dhuna familjare dhe në bazë gjinore⁸⁹

Ligji për preventivë, parandalim dhe mbrojtje nga dhuna familjare⁹⁰ parasheh parashtrim të masave të përkohshme për mbrojtje të kryerësit të dhunës familjare për shkak të ndaluarit për të kryer dhunë, anashkalim të pasojave nga dhuna e kryer dhe ndërmarrje të masave ndaj kryerësit të dhunës, si dhe për shkak të eliminimit të shkaqeve për kryerjen e mëtejme të dhunës familjare⁹¹. Masa e përkohshme për mbrojtje mund të zgjat më së paku tre muaj, kurse më shumë deri në një vit. Nëse dhuna familjare vazhdon pas skadimit të periudhës për të cilën është parashtruar në kuadër të afatit deri në një vit nga paragrafi 1 i këtij neni, viktimë ose qendra për punë sociale mund të parashtrojë kërkesë për vazhdim të masës/ave. Pasi të kalojë një vit nga masa e përkohshme e parashtruar për mbrojtje në rast kur dhuna familjare përsëri ndodh, viktimë ose Qendra e Punës Sociale parashtron kërkesë të re të gjykata. Derisa vlerësohet se ajo e ka arritur qëllimin, viktimë ose Qendra e Punës

⁸⁹ Kjo pjesë është përgatitur në bashkëpunim me zotëri Stojan Mihov, ish gjykatës në Gjykatën Themelore - Shtip, i prezantuar në kuadër të debatit profesional të mbajtur më datë 09.04.2019 në Hotel “Aleksandër 2” – Shkup.

⁹⁰ Ligji për preventivë, parandalim dhe mbrojtje nga dhuna familjare.

⁹¹ Ndalesë për kërcënim se do të kryejë dhunë familjare; ndalesë që të maltretojë, të shqetësojë, të telefonojë, të kontaktojë ose mënyrë tjetër e komunikimit me anëtarë të familjes, direkt ose indirekt; ndalesë që të afrohet në distancë më të vogël se 100 metra nga vendbanimi, shkolla, vendi i punës ose vendi i caktuar të cilin rregullisht e viziton anëtar tjetër i familjes; largim nga shtëpia pavarësisht pronësisë; ndalesë për posedim të armës së zjarrit dhe të llojit tjetër ose ajo t’i merret; detyrim që t’i kthejë lëndët të cilat janë të nevojshme për plotësim të nevojave të përditshme të familjes; detyrim ligjor për qëndrueshmëri të familjes; detyrim për vizitë të këshilltores adekuate; mjekim i detyrueshëm i kryerësit, derisa keqpërdor alkool, drogë dhe substancë psikotrope apo ka çrregullim psikik; detyrim për kompensim të shpenzimet mjekësore dhe të tjera të shkaktuara nga dhuna familjare; dhe parashtrim i çdo mase tjetër të cilin Gjykata do ta konsiderojë si të domosdoshme për sigurim të sigurisë dhe mirëqenies së anëtarëve të tjerë të familjes.

Sociale mund të parashtrojë propozim deri te gjykata kompetente për shfuqizim të masës së përkohshme të parashtuar për shkak të së cilës është parashtuar. Viktima ose Qendra e Punës Sociale mund të parashtrojnë propozim për ndryshim të masës së përkohshme të parashtuar për mbrojtje ose për vazhdim të saj derisa masa e parashtuar nuk ka siguruar mbrojtje adekuate të viktimës ose kemi ndryshim të rrethanave.

Në procedurat në të cilat në gjykatat vendos për masa të përkohshme për mbrojtje zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurë gjyqësore nëse me këtë Ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Në vendimin në të cilin është/janë parashtuar masa/t e përkohshme për mbrojtje, Gjykata do ta obligojë kryerësin e dhunës familjare që ta respektojë vendimin gjyqësor. Ankesa kundër vendimit të Gjykatës Themelore për parashttrimin e masës së përkohshme për mbrojtje – largim të kryerësit nga shtëpia dhe ndalim për t’iu afruar shtëpisë apo për masën e përkohshme për mbrojtje – mund të deklarohet në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Ankesa e deklaruar kundër vendimit të Gjykatës nuk nënkupton parashttrimin e saj.

Ministria e Punëve të Brendshme e zbaton masën e përkohshme të shqiptuar për mbrojtje – largimin e kryerësit nga shtëpia dhe ndalesë për t’iu afruar shtëpisë dhe masën e përkohshme ndalesë të kanosjeve se do të kryejë dhunë familjare; ndalesë që të maltretojë, të shqetësojë, të telefonojë, të kontaktojë ose mënyrë tjetër të komunikimit me anëtarë të familjes, direkt ose indirekt; ndalesë që të afrohet në distancë më të vogël se 100 metra prej vendbanimit, shkollës, vendit të punës ose vendit të caktuar të cilin rregullisht e viziton anëtari tjetër i familjes; largim nga shtëpia pavarësisht pronësisë, ndalesë për të poseduar armë zjarri dhe të llojit tjetër ose ajo t’i merret.

Ministria e Shëndetësisë e realizon masën e shqiptuar për mbrojtje – mjekim i detyrueshëm të kryerësit apo autorit nëse është keqpërdor alkool, drogë dhe substanca të tjera psikotrope apo ka çrregullim psikik.

Zbatimi i masave të përkohshme të shqiptuara për mbrojtje– detyrim që t’i kthejë lëndët ose gjësendet të cilat janë të nevojshme për plotësimin e nevojave të përditshme të familjes; detyrim ligjor për kujdes ndaj familjes, detyrimisht t’i kompensojë shpenzimet mjekësore dhe të tjerave të shkaktuara nga dhuna familjare dhe shqiptimin edhe të ndonjë mase tjetër të cilën gjykata do ta konsiderojë si të domosdoshme për t’u realizuar në pajtim me Ligjin.

Këshillimorja për kryerësit e dhunës familjare e zbaton masën e shqiptuar për mbrojtje – detyrimisht të vizitojë këshillimore adekuate.

Këto dispozita janë në pajtueshmëri me nenin 18 të Konventës së Stambollit, por sa i takon kriminalizimit të veprave të dhunës në baza gjinore, nëpërmjet rregullimit të tyre në Kodin Penal, përveç se masat për mbrojtje të viktimave duhet të rregullohen në lex specijalis për dhunë në baza gjinore, ato duhet të kenë bazë ligjore edhe në Kodin Penal. Konventa e Stambollit në këtë kuptim i obligon shtetet “t’i ndërmarrin legjislacionet e nevojshme apo masa të tjera... gjatë mbrojtjes dhe përkrahjes së viktimave dhe dëshmitarëve të të gjitha formave të dhunës të përfshira me Konventën”.

Ekspertët vërtetojnë se masat për mbrojtje të përkohshme janë më efektive nëse do të ketë përgjegjësi penale për mosrespektim të tyre. Në të vërtetë, praktika gjyqësore ka treguar se në rastet ku nuk respektohet masa e parashtuar me vendim gjyqësor, gjykata parashtrohet dënim në bazë ligjore të nenit 377 paragrafi 8 nga Kodi Penal, respektivisht për veprën penale “moszbatim të vendimit gjyqësor”. Në njërin nga rastet e analizuar, dënimi është shqiptuar në tre (3) vjet, në bazë të Rregullores së Matjes së Dënimeve.⁹² Në këtë rast aktgjykimi i Gjykatës Themelore është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, me sqarimin se gjykata e shkallës së parë gjatë sjelljes së aktgjykimit nuk ka kryer asnjë shkelje thelbësore, dhe drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, drejtë e ka zbatuar KP-në dhe drejtë e ka matur dënimin për veprën penale të kryer. Në rastin konkret, Gjykata mosshqiptimin e masës së mbrojtjes e ka marrë si rrethanë e shkaktuar gjatë matjes së dënimit ndaj të akuzuarit. Në mënyrë shtesë, Gjykata e ka pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit gjatë kryerjes së veprës penale, se vepra penale është kryer pa shkas dhe shkak, se ai deri tash është gjykuar në më shumë raste për kryerje të veprave penale të llojit të njëjtë, për çfarë ka vuajtur edhe dënim me burg, si dhe ajo se vepra penale është kryer në prani të fëmijëve.

Në rastin e dytë të analizuar me bazë të njëjtë ligjore (n. 377, p. 5), Gjykata e ka pranuar propozimin e Prokurorisë Publike kompetente për miratim të aktgjykimit për parashtrim të aktgjykimit, ka sjellë vendim të tillë edhe ndaj të akuzuarit për kryerje të veprës penale dhe ka shqiptuar dënim me kusht, me çka të akuzuarit për kryerje të veprës penale i ka caktuar dënim me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjetësh, zbatimi i të

.....
⁹² Për shembull: në rastin i akuzuari edhe pse ka qenë i obliguar të veprojë ndaj vendimit gjyqësor të plotfuqishëm, të sjellë në procedurë për dhënien të urdhrat për mbrojtje të të drejtave LGJ2 nr.9/14 viti 14.07.2014, e Gjykatës Themelore, me të cilën është parashtruar “ndalesë që të kërcënohet se do të kryejë dhunë familjare” nga n. 35 p. 1 nga Ligji për preventivë, parandalim dhe mbrojtje nga dhuna familjare nuk ka vepruar ndaj saj.

cilit është shtyrë në afat prej dy vjetësh, me kusht nëse i akuzuari nuk kryen vepër penale. Në të njëjtën kohë, ekspertët vlerësojnë se, Gjykata gjatë miratimit të aktgjykimit për dhënie të urdhëresës për dënim “Duhet të veprojë me vëmendje të lartë, sepse viktimë e dhunës familjare nga dhuna që i është kryer viktimës mund të ketë trauma afatgjata dhe pa verifikim të gjykatës apriori të sillen aktgjykime të tilla, dhe të mos dëgjohet zëri i viktimës, nuk duhet të praktikohet. Procedura për shqiptimin e aktgjykimit me të cilën shqiptohet urdhëresa ndëshkuese për kryerësit e dhunës familjare, konsiderojmë se nuk duhet të praktikohet”⁹³.

PËRFUNDIME

Konventa e Stambollit ka për qëllim t’i mbrojë gratë dhe t’i eliminojë të gjitha format e dhunës dhe diskriminimit për promovimin e barazisë ndërmjet burrave dhe grave, si dhe t’i fuqizojë gratë. Kodi Penal duhet ta trajtojë çështjen e diskriminimit dhe jobarazisë bashkë me çështjen e dhunës ndaj grave me përshkrimin e veprave penale të reja dhe zbatimit të dispozitave penale të parapara me Konventë. Për momentin, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut e kriminalizon vetëm përdhunimin (edhe atë pjesërisht, jo në tërë vëllimin siç e parasheh Konventa).

Format e tjera të dhunës ndaj gruas të rregulluara me nenet 33, 34, 35, 36, 37, 38 dhe 39 të Konventës së Stambollit nuk janë të rregulluara në mënyrë eksplicite në Kodin Penal. Disa nga këto forma të dhunës janë të rregulluara pjesërisht me KP-në ose me ligje tjera.

Sa i takon gjuhës që e përdor, Kodi Penal është gjinor neutral (si neutral përdor emra të dominimit mashkullor dhe që vlen për të gjithë), por edhe në lidhje me njohjen e pabarazisë gjinore, roleve gjinore dhe stereotipave si shkak për vepra penale të cilat janë rregulluar me Konventën.

Më pas, Kodi Penal maqedonas e mbron vetëm integritetin trupor dhe jetën e viktimave, por jo edhe integritetin psikik. Nga këtu nuk e njeh veprën penale dhunë psikike si të veçantë, as edhe përdhunimi dhe përndjekje, as edhe i rregullon elementet e shkakut të frikës dhe shqetësimit. Qasja e tillë sjellë kulminacionin gjatë përkufizimit të përdhunimit ku elementi kyç është zbatimit i dhunës trupore, dhe jo mungesa e vullnetit dhe pajtimit për marrëdhënie seksuale. Nga këtu, ndryshimi i

⁹³ Zotëri Stojan Mihov, ish gjykatës në Gjatën Themelore - Shtip, diskutim në kuadër të debatit profesional të mbajtur më datë 09.04.2019 në Hotel “Aleksandër 2” – Shkup.

paradigmës e cila dëshirohet të vihet me Konventën e Stambollit kërkon ndryshime rrënjësore në konceptin e përkufizimit të veprave penale në legjislacionin maqedonas.

Rregullimi i veprave të cilat i përkufizon Konventa e Stambollit si të ndara nga Kodi Penal do të mundësojë zbatim të Konventës edhe në raport të grumbullimit të të dhënave për shkak se, grumbullimi i të dhënave nga ana e MPB-së dhe organeve gjyqësore është sipas nenit të Kodit Penal, dhe jo sipas paragrafit (dhuna familjare si element kualifikues i disa veprave penale gjithmonë përmendet në paragrafin e dytë, që pamundëson grumbullimin e të dhënave).

Rekomandime

6.1 Instrumenti për ratifikimin e Konventës së Stambollit

- ✓ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ta braktisë rezervën e nenit 55 të Konventës.

6.2 Përkufizimi i termeve baze të Konventës së Stambollit

- ✓ Të zgjerohet vëllimi i Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna familjare ose të zëvendësohet me ligj të ri i cili do t'i rregullojë të gjitha format e dhunës me bazë gjinore.
- ✓ Kodi Penal t'i definojë të gjitha format e dhunës ndaj grave si veprë penale, por njëkohësisht ta përkufizojë termin gjini, ta rishikojë gjuhën nga gjinor neutral në gjinor përgjegjës dhe t'i njohë gratë si subjekte, por edhe viktimat të sjelljeve të dhunshme.
- ✓ Të definohet dhuna me bazë gjinore dhe dhuna ndaj grave në Kapitullin e tridhjetë – domethënia e shprehjeve të këtij Ligji – Neni 122, me zëvendësim të përkufizimit për dhunë familjare; Të përkufizohet gjinia në Kapitullin e tridhjetë – domethënia e shprehjeve në këtë Ligj – Neni 122.
- ✓ Të plotësohet përkufizimi i viktimës me qëllim të njohjes së gruas si viktimë e dhunës së bazuar në gjini në Kapitullin e tridhjetë – domethënia e shprehjeve të këtij Ligji Neni 122.
- ✓ Në Kodin Penal të zëvendësohet përdorimi i “dhunës familjare” me “dhunë të bazuar në gjini dhe në shtëpi” si faktor shtesë për nevojat e dënimit nëse ndodh njëkohësisht me tjetër veprë penale, si për shembull: vrasje (neni 123); vrasje e momentit (neni 125); lëndim trupor (neni 130); lëndim trupor i rëndë (neni 131); detyrim (neni 139); privim i padrejtë nga liria (neni 140); rrezikim i sigurisë (neni 144); sulm ndaj fëmijës që nuk i ka mbushur 14 vjet

(neni 188) dhe ndërmjetësim në kryerjen e prostitucionit (neni 191).

- ✓ Realizim i trajnimeve për palët e prekura në proces (punëtorë socialë, policë/gra, avokatë, organizata qytetare, gjykatës, etj.)

6.3 Kriminalizimi i të gjitha formave të dhunës ndaj gruas

Që të mund të operacionalizohet rekomandimit, nevojitet të bëhet:

- ✓ Revizion i Kodit Penal për shkak të përdorimit të fjalorit gjinor të ndjeshëm kundrejt atij neutral i cili përdoret për momentin.
- ✓ Revizion i Kodit Penal për shkak të futjes së perspektivës gjinore në të, garantim se janë marrë parasysh dimensionet gjinore gjatë përkufizimit të veprave penale dhe miratimit të procedurave të këtij Ligji.
- ✓ Ndryshime në Kodin Penal (neni 186) me qëllim që përkufizimi i përdhunimit dhe krimeve të tjera seksuale të bazohet në mungesë të pajtueshmërisë dhe njëkohësisht të mbulohen të gjitha format e penetrimit jokonsensual (penetrimit trupor vaginal, anal dhe oral), përfshirë edhe pjesët apo mjetet trupore dhe të përfshijë dhunën në martesë.
- ✓ Ndryshime në Kodin Penal me qëllim të përkufizimit të dhunës psikike.
- ✓ Të rregullohet më tej n. 144 – rrezikimi i sigurisë të thirret edhe në integritetin trupor dhe në gjendjen psikike të frikës apo të inkriminohet përndjekja si vepër penale e re me dispozita të cilat do të parashihen dhe sanksionohen për kryerësit, kurse njëkohësisht do të sigurohet mbrojtje për viktimat.
- ✓ Të rregullohet shqetësimi seksual si vepër penale në Kodin Penal dhe të përkufizohen sanksione të përshtatshme për kryerësit.
- ✓ Të rregullohet më tej n. 18 – të inkriminojë mashtrimin e të moshuarit apo fëmijës në territorin e shtetit apo në shtet tjetër me qëllim të detyrohen i moshuari apo fëmija të hynë në martesë.

- ✓ Të rregullohet ndalesë e tërësishme e martesës për personat e mitur me persona të mitur.
- ✓ Të rregullohet më tej n. 130 dhe 131 me rregullim eksplicit të gjymtimit të gjenitaleve femërore dhe parashikim i masave ligjore për luftë kundër ofrimit të realizimit të procedurës për gjymtim të gjenitaleve femërore.
- ✓ Futje e plotë dhe harmonizim i legjislaturës së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me Konventën sa i takon rrethanave të rënduara gjatë matjes së dënimit për veprat e rregulluara me Konventë.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

364.63-055.2:343.3/.7(497.7)(094.5)

364.63-055.2:341.24(560.118)

RISTESKA, Marija

Analizë e nevojave prej harmonizimit të kodit penal me konventën e Stambollit në Republikën e Maqedonisë së Veriut / autorë Marija Risteska, Aleksandar Cekov. - Shkup : Qendra për hulumtim dhe krijim të politikave, 2019. - 57 стр. ; 30 см

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4586-64-7

1. Cekov, Aleksandar [автор]

а) Насилство врз жени - Кривичен законик - Истанбулска конвенција - Усогласување - Македонија

COBISS.MK-ID 110577674

